



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 12958 prot.

Vlorë, më 15 08 2024

PROJEKT VENDIM
Nr _____, Datë _____ 2024

**“PËR MIRATIMIN PËR SHITJEN ME ANKAND TË AKSIONEVE TË
KLUBIT TË FUTBOLLIT “K.F ORIKU ”**

Bazuar në Ligjin 8417, neni 113, pika 2, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar ; Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, gërma e, i ndryshuar , neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma b, nënpika 1.2, gërma a ; Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar; Ligjit nr. 105/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin” ; Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008, neni 8, “Për Ankandin Publik” i ndryshuar ; VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” i ndryshuar, VKB nr. 4, datë 25.02.2013 (ish Bashkia Orikum) dhe Raportin e Vlerësimit nga KEI-AL Auditing,

V E N D O S I:

- 1.Miratimin për shitje në vlerën 100 % të aksioneve që Bashkia Vlorë zotëron si aksionare në Shoqërinë “K.F Oriku” Sh.A.
- 2.Miratimi i Raportit të Vlerësimit K.F.Oriku Sh.A nga Kei-Al Auditing, datë 25.07.2024
- 3.Çmimi minimal i shitjes së 100% të kuotave është 12,658,000 lekë.
- 4.Forma e shitjes së aksioneve që zotërohen nga Bashkia Vlorë në Shoqërinë “K.F Oriku” Sh.A, të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese: Procedurë e Hapur Standard e Ankandit, sipas dokumenteve tip të Ankandit, bashkëngjitur këtij projekt vendimi.
- 5.Procedura e ankandit për shitjen e 100% të aksioneve, që zotëron Bashkia Vlorë, të bëhet në vlerën 12,658,000 lekë.
- 6.Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
Ky projekt vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ermal Dredha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 12958 prot.

Vlorë, më 15 08 2024

RELACION

**MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR MIRATIMIN PËR SHITJE ME ANKAND
TË AKSIONEVE TË KLUBIT TË FUTBOLLIT K.F ORIKU SH.A”**

PARA KËSHILLIT TË BASHKISË

Të nderuar këshilltarë!

Projekt Vendimi i cili paraqitet për miratim në Këshillin e Bashkisë Vlorë ka si objekt shitjen me ankand të aksioneve të klubit të futbollit “K.F Oriku” Sh.A.

Shoqëria “K.F Oriku” Sh.A është themeluar me Vendimin Nr. 4, datë 25.02.2013 nga Këshilli i Bashkisë Orikum dhe regjistruar në datën 21.03.2013 me NIPT L36521202N, me seli në adresën Orikum, Lagjia “1 Maji”, Rruga “Bulevardi Princesha Rugjinë” Vlorë me aktivitet: Organizimi i aktiviteteve sportive të futbollit; Krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në gara sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit, Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe ndërkombëtare. Futja në tregun e lojrave për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit. Aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë dhe Bashkisë.

Në vitet e fundit, Oriku ka qënë më aktiv, me ambicie për të arritur në Kategorinë Superiore që është niveli më i lartë i futbollit në Shqipëri. Klubi i futbollit Oriku, është një klub futbollit në Orikum, pranë qytetit të Vlorës i cili ka bërë përpjekje për të përmirësuar infrastrukturën dhe ekipin, duke synuar promovimin dhe qëndrueshmërinë në nivelet më të larta të ligës në Shqipëri. “K.F Oriku” Sh.A luan ndeshjet e tij si vendas në “Stadiumin e Orikumit” i cili referuar pasqyrave financiare të klubit rezulton se është pronë e Bashkisë Vlorë.

Shoqëria “KF Oriku” Sh.A është regjistruar me një kapital themeltar prej 4.100.000 lekë, i ndarë në 4.100,00 aksione me vlerë nominale 1.000 lekë secila, aksioner është 100% Bashkia Vlorë. Referuar ligjit 105/2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 79/2017 “Për Sportin”, neni 8 , pika 1, parashikon se institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në



fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Bazuar në kontratën Nr. 5905, datë 18.04.2024; Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; Ligjit nr. 105/2020, datë 29.07.2020 i ndryshuar, e lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe Shoqërisë Kei-Al Auditing është kërkuar një analizë vlerësimi për të përcaktuar vlerën e asetëve të Shoqërisë për privatizim më 31.12.2023. Objekti i vlerësimit është të shprehë një opinion të pavarur mbi vlerën e drejtë të Shoqërisë, mbi bazën e vazhdimësisë, më 31 dhjetor 2023.

Vlerësimi i shoqërisë është bërë në bazë të parimit të vazhdimësisë, nën supozimin se Shoqëria do të kryejë vetëm ato strategji financiare dhe operacionale që do ti mundësojnë shoqërisë zhvillimin në të ardhmen.

Bazuar në raportin e vlerësimit nga Kei-Al Auditing vlera e shoqërisë K.F Oriku Sh.A është 12,658,000 lekë e cila përbëhet nga:


Vlera e shoqërisë	12,658,000 lek
Asetet	88,908,00 lek
Emri i mirë	3,042,018 lek
Detyrimet afatshkurtra	6,092,601 lek
Kapitali neto	3,434,473 lek

Kërkojmë nga ju miratimin e Raportit të Vlerësimit të Shoqërisë K.F Oriku Sh.A nga KEI-AL Auditing dhe të këtij Projekt Vendimi për vazhdimin më tej të procedurave për shitjen në ankand të aksioneve të klubit të futbollit “K.F Oriku” Sh.A.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Ermal Dredha



Dokumentet standarde te Ankandit Publik



REPUBLIKA E SHQIPERISË

DOCUMENTET STANDARDE TË ANKANDIT PUBLIK

Tabela e Përmbajtjes

1. NJOFTIMI I ANKANDIT	
2. UDHËZIME PËR ZHVILLIMIN E ANKANDIT.....	
3. UDHËZIME PËR KANDIDATET BLERËS.....	
4. PJESMARRJA DHE KUALIFIKIMI.....	
5. VLERËSIMI I OFERTAVE DHE ZHVILLIMI I ANKANDIT.....	
6. PROCEDURA E ANKIMIT.....	
7. NËNSHKRIMI I KONTRATËS.....	
8. SHTOJCAT.....	

SHTOJCA 1

NJOFTIMI I ANKANDIT

1. Autoriteti shites:

Emri: BASHKIA VLORE

Adresa: Rruga "Zigur Lelo" Lagja "4 Heronjtë" Vlorë 9400

Tel/Fax: 033 231 000

E-mail: info@bashkiavlore.gov.al

Faqe e internetit: www.bashkiavlore.gov.al

2. Data e zhvillimit të ankandit

Data e zhvillimit të ankandit: /2024

3. Lloji i Procedurës standarde të ankandit:

4. Objekti i Shitjes: Bashkia Vlorë shet me ankand 100% të aksioneve të saj në "K.F ORIKU" sh.a

5. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes: Shoqëria "KF Oriku" sh.a (shoqëri anonime), është krijuar më datë 25.02.2013 dhe i regjistruar në QKB në datë 21.03.2013 me NIPT L36521202N, ku aksionet zotërohen 100% nga Bashkia Vlorë, me seli në adresën Orikum, Lagja "1 Maj", Rruga "Bulevardi Princesha Rugjine" Vlorë. Në mënyrë më të zgjeruar objekti i shitjes përshkruhet në Shtojcën 10, Specifikimet teknike.

6. Vlera fillestare: Vlera fillestare me të cilin fillon ankand publik është 12.658.000 lekë (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë

7. Vendi i zhvillimit të ankandit: Bashkia Vlorë, Rruga "Zigur Lelo", Lagja "4 Heronjtë"

8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje është data /2024

9. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të trerhiqen pranë autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

Po

Jo

Nëse Po

Monedha _____

Çmimi _____

Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- » Formulari i njoftimit;
 - » Kërkesa për pjesëmarrje;
 - » Formulari i ofertës;
 - » Ftesa për oferte;
 - » Formulari i njoftimit te fituesit;
 - » Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
 - » Procesverbal/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.
10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.

SHITJCA 2

FTESA PËR OFERTE

Seksioni I Autoriteti Shitës

I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia Vlore
Adresa Sheshi "4 Heronjtë", Rruga "Zigur Lelo", Lagja "4 Heronjtë"
Tel/Fax 033 231 000
E-mail info@bashkiavlorw.gov.al
Adresa e Internetit www.bashkiavlore.gov.al

I.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës:

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____

I.3 Lloji i autoritetit shites dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion qëndror

Institucion i pavarur

Njësiti e qeverisjes vendore

Tjetër

Shoqëri tregtare

Ndërmarrje shtetërore

Seksioni II Objekti i ankandit publik

II.1 Shitja

Objekte

Shërbime

Mallra

II.2 Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes

1. Vlera fillestare 12,658,000(dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë)Lekë.
2. Qëllimi i shitjes, sasite:

Qëllimi i shitjes është shitja me ankand i 100% e aksioneve që Bashkia Vlorë disponon në “K.F ORIKU” sh.a

II.4 Vendndodhja e objektit të shitjes:

Lagja “1 Maj”, Rruga “Bulevardi Princesha Rugjine” Vlorë

II.5 Ndarja në LOTE:

Po Jo X

Nëse po,

II.6 Përshkrim i shkurtër i loteve

(Sasia ose synimi dhe vlera fillestare e LOTEVE)

1. _____
 2. _____
 3. _____
- etj__

Seksioni III Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

III.1 Informacion mbi statusin ligjor të shoqërisë

Shoqëria “K.F Oriku” sh.a është krijuar dhe regjistruar në QKB me NIPT L36521202N, me seli në adresën Oriku, Lagja “1 Maj”, Rruga “Bulevardi Princesha Rugjine” Vlorë, me aktivitet të veprimtarisë : Organizimi i aktiviteteve sportive të futbollit: Krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në gara sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit, Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të futbollit dhe të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe ndërkombëtare. Futja në tregun e lojtrave për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit. Aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë dhe bashkisë.

Shoqëria “K.F Oriku” sh.a, Vlorë është regjistruar si shoqëri në datën 21.03.2013, me kapital themeltar prej 4.100.000 lekë, i ndarë në 4.100,00 aksione me vlerë nominale 1.000 lekë secila, Aksioner është 100% Bashkia Vlore. Organet e shoqërisë KF Oriku sh.a Vlorë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme
- b) Këshilli i Mbikqyrjes

III.2 Sigurimi i Ofertës:

Sigurimi i ofertës do të jetë në shumën 253.160 (Dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë lekë sa 2% e vlerës fillestare të ankandit) me afat 150 ditë

Seksioni IV Procedura

IV.1 Lloji i procedurës:

E hapur	Me	Me
	përzgjedhje	negocim
	të blerësve	
X		

IV.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i lartë

Informacione të mëtejshme në dokumentat e ankandit publik

IV.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: / / (dd/mm/vvvv) Ora: :

Vendi: Bashkia Vlorë, Rruga "Zigur Lelo" Lagja "4Heronjtë"

IV.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: / / (dd/mm/vvvv) Ora: :

Vendi: _____ Bashkia Vlorë, Rruga "Zigur Lelo" Lagja "4Heronjtë"

IV.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150 ditë

IV.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	x	Anglisht
Tjetër		_____

Seksioni V Informacione plotësuese

V.1 Dokumente me pagesë:

	Po	Jo	x	
Nëse Po				
	Monedha	_____	Çmimi	_____

V.3 Publikime të mëparshme, lidhur me të njëjtin objekt shitje (nëse zbatohet):

Buletini i Njoftimeve Publike Data _____ Numri _____

V.4 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumenteve të ankandit)

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi / /

2. UDHEZIMET PËR ZHVILLIMIN E ANKANDIT

- 2.1 Procedura e ankandit publik do të kryhet në përputhje me Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2002, "Për Ankandin Publik", me Rregullat për Ankandin Publik, miratuar me VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, dhe me këtë Dokumentacion për Ankandin Publik.
- 2.2 Çdo Kandidatë blerës ftohet të dorëzojë ofertë. Oferta me çmimin me te larte do te shërbeje si vlere fillestare për fillimin e ankandit. Kontrata e shitjes do t'i akordohet atij Kandidatë blerës që ofron çmimin me te larte gjate zhvillimit te procedurës se ankandit publik.
- 2.3 1. Autoriteti shitës lejohet që, në çdo kohë, të anulojë ankandin, për arsye të interesit publik, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës. Autoriteti shitës në asnjë rast nuk është i detyruar të shpallë fituesin për një ankand.
2. Autoriteti shitës nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve, që kanë paraqitur oferta, për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.
3. Autoriteti shitës, në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, u komunikon të gjithë kandidatëve blerës ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar ankandin brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit.
4. Autoriteti shitës boton njoftimin për anulimin e ankandit brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit për anulim.
5. Të gjithë te interesuarit që kanë dorëzuar një ofertë ose kanë marrë pjesë në procedurë do të njoftohen për vendimin e marrë dhe arsyet për anulimin e procedurës së ankandit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
6. Autoriteti shitës, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave të ankandit dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një kandidat, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e ankandit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë kandidatëve

blerës, që kanë tërhequr dokumentet e ankandit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. Në çdo rast, autoriteti shitës e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 5 ditë.

2.4 Termat e përdorur në Dokumentet e ankandit publik kanë kuptimet e mëposhtme:

“Person(-a) i(të) Autorizuar” - person(a) të autorizuar nga Autoriteti Shitës të veprojnë në emër të tij dhe person(a) të autorizuar me Prokurë të Posaçme, autorizim me shkrim ose me një mënyrë tjetër ligjore për të vepruar në emër të Ofertuesit.

“Autoriteti Shitës” – [*emri i autoritetit shitës*]

“LAP” - Ligji nr. 9874, datë 14.02.2002, “Për Ankandin Publik”.

“Procedura e Ankandit Publik” – procedurë e kryer nga Autoriteti shitës, bazuar në këtë Dokumentacion Ankandi.

“Rregullat e Ankandit Publik” – Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të LAP, që përfshin veç të tjerave, Rregullat e Ankandit Publik, të miratuara nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 1719, datë 17.12.2008.

“Kandidatë blerës” janë të gjithë personat fizikë apo juridikë që kërkojnë të marrin pjesë me ofertën e tyre në procedurën e shitjes publike nëpërmjet ankandit publik.

“Ofertues” – çdo operator ekonomik që ka paraqitur një ofertë, në pajtim me DA.

“DA” – ky Dokumentacion Ankandi.

UDHËZIME PËR KANDIDATET BLERËS

Mënyrat e komunikimit me ofertuesit

3.1 I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit (korrespondenca) ndërmjet Autoritetit Shitës dhe Kandidateve blerës duhet të bëhet me shkrim, siç përcaktohet në Nenin 11 të LAP.

3.2 Në veçanti, komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit kryhet nëpërmjet E-mail: info@bashkiavlorë.gov.al (psh, postë, faks, mjete elektronike (në adresë interneti të përmendur në seksionin 2 të DA). Do të konsiderohet se korrespondenca është dorëzuar në kohën e duhur, nëse përmbajtja e saj, me shkrim, sipas nenit 11 të LAP, ka mbërritur tek Autoriteti Shites para skadimit të afatit kohor.

Hartimi i ofertës

3.3 Kandidatet blerës janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DA. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DA do të refuzohen si të papranueshme.

- 3.4 Kandidatet blerës përballojnë kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti shitës nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 3.5 Oferta dhe të gjithë dokumentet e korrespondenca që lidhet me ofertën, e shkëmbyer ndërmjet Kandidatit blerës dhe Autoritetit shitës duhet të përgatiten në gjuhën shqip/ose _____ (nëse është e zbatueshme). Materialet mbështetëse dhe literatura e printuar, që paraqitet nga Ofertuesi mund të jetë e shkruar edhe në një gjuhë tjetër që përdoret gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare, me kusht që këto dokumente të shoqërohen me përkthimin e duhur në gjuhën e ofertës, të fragmenteve përkatëse.
- 3.6 *(opsion).*
Një takim sqarues do të organizohet në _____ (da/om/av) në mënyrë të tillë që Kandidatet blerës të mund të familjarizohen me DA dhe kërkesat e saj. Pjesëmarrja është fakultative, por Kandidati i interesuar Blerës duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë takimit do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime, të cilat do tu shpërndahen të gjithë Kandidateve blerës. Të gjitha kostot e Kandidateve blerës që lidhen me takimin duhet të mbuloohen nga vetë ata.
- Për të organizuar takimin ju lutem kontaktoni: (përqarktoni personin e kontaktit)
- 3.7 Origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar.
Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomik, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së ankandit (Prokura mund të përfshijë edhe autorizimin për të nënshkruar një kontratë).
- 3.8 **Oferta duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme:**
- Formularin e Ofertës, në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojca 3 në DA
 - Dokumentet dhe vërtetimet e përmendura në Seksionin 4 të DA.

Një Kandidat blerës duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Fshehtësia

- 3.9 Autoriteti shitës nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga kandidatët blerës ose ofertuesit, të etiketuar si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.
- 3.10 Kandidatet blerës duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për blerjen e _____; Nr Kontratës _____"

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I ANKANDIT, DHE JO PARA _____ (dd/mm/vv) _____ orës”.

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike kandidatet blerës duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të ëeb-it të APP-së, www.app.gov.al

Llogaritja e çmimit

- 3.11 Kandidati blerës duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DA, duke përcaktuar një liste të hollësishme çmimesh që përbejnë çmimin e plote.
- 3.12 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare dhe kursi i shkëmbimit duhet të jetë ai i fiksuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën kur publikohet njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhet në atë kurs shkëmbimi deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
- 3.13 Ofertuesi duhet të shënojë në Programin e Çmimit çmimet totale të ofertës pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.
- 3.14 Çmimet e dhëna nga Ofertuesi duhet të jenë të fiksuar përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi në asnjë aspekt. Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm, dhe që nuk është në përputhje me këtë paragraf, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktor si e papranueshme.

Afati kohor dhe vendi për dorëzimin e ofertave

- 3.15 Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme:

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike kandidatet blerës duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të ëeb-it të APP-së, www.app.gov.al

- 3.16 Afati kohor për dorëzimin e ofertave skadon më _____ (dd/mm/vv) në _____ ora.

Ofertat e paraqitura pas skadimit të afatit kohor do t'i rikthehen të pahapura Kandidateve blerës përkatës.

Në rastin e prokurimit elektronik afati kohor për dërgimin e ofertës skadon në momentin e orës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor për hapjen e ofertave.

Data dhe vendi për hapjen e ofertave

- 3.17 Hapja publike e ofertave do të kryhet ne momentin e fillimit te ankandit publik më _____ (dd/mm/vv) në _____ ora, në _____ zyra _____ .
Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre **duhet të jenë** të pranishëm në hapjen e ofertave. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave duhet t'i komunikohet të gjithë Kandidateve blerës te pranishëm. Oferta me vlerën me te larte do te shërbeje si vlere fillestare e fillimit te procedurës se ankandit publik.

Kur oferta paraqitet me mjete elektronike Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre duhet të jenë të pranishëm në hapjen e ofertave. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave duhet t'i komunikohet Kandidateve Blerës te pranishëm që kanë dorëzuar oferta në bazë të kërkesës së tyre me mjete elektronike.

Sigurimi i ofertës

(OPSION)

- 3.18 Që një Kandidat blerës të marrë pjesë në një procedurë ankandi, kërkohet që të paraqesë Sigurimin e Ofertës, shoqëruar me Formularin e Sigurimit të Ofertës.
Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës **është** _____ Lekë (shuma e shprehur në fjalë : _____).

(OPSIONALE: nëse Autoriteti Shitës e ndan objektin e ankandit publik në Lote)

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës për secilin nga Lotet është si më poshtë:

Loti 1 _____ Lekë

Loti 2 _____ Lekë

- 3.19 Sigurimi i Ofertës duhet të dorëzohet bashke me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.
- 3.20 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare e pakushtëzuar,
 - b) garanci sigurimi
- Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet se bashku me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.
- 3.21 Dokumentet e përmendur në pikën a – b) duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës të ofertës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

- 3.22 Ofertat duhet të jenë të vlefshme për 150 (ditë) që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave.

4. PJESMARRJA DHE KUALIFIKIMI

Kërkesat për kualifikim dhe vërtetimet e kërkuara

- 4.1 Në përputhje me LAP, Kandidatet blerës duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme për tu kualifikuar:

- a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet standarde të ankandit;
- b) vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- c) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
- ç) ne rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e të cilit depozitohet pranë komisionit të ankandit

Bashkimi i kandidateve blerës

- 4.7 Oferta mund të paraqitet nga një grup kandidatesh blerës, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë ekzekutimit të kontratës.
- 4.8 Para dorëzimit të ofertës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht me anë të një marrëveshjeje të noterizuar, në të cilën tregohet përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes dhe sasia e mallrave konkrete për secilin anëtar, si dhe autorizimi/prokurën për përfaqësimin e anëtarëve të grupit, si për dorëzimin e ofertës ashtu edhe për lidhjen e kontratës në rast të shpalljes fitues. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen si bashkim të operatorëve ekonomikë.

5. VLERËSIMI I OFERTAVE DHE ZHVILLIMI I ANKANDIT

Oferta e vlerësuar si më e larta do të shërbejë si vlerë fillestare për zhvillimin e procedurës së ankandit.

Komisioni i ankandit pasi deklaron vlerën fillestare të ankandit pas hapjes së ofertave, deklaron hapin e dhënies së ofertave mbi vleftën fillestare për pjesëmarrësit në ankand si dhe drejton marrjen e ofertave nga pjesëmarrësit në ankand.

Vleftha e hapit të zhvillimit të ankandit do të jete nga 2-5 % e vlerës fillestare të ankandit dhe vendoset nga komisioni i ankandit përpara zhvillimit të ankandit.

Ne përfundim hartohet proces – verbali i ankandit.

Komisioni i ankandit, do të shpalle fitues, pjesëmarrësin që ka ofruar vlerën më të lartë ne favor të autoritetit shitës për blerjen e objektit të shpallur për shitje.

Ndalimi i negociatave

- 5.1 Nuk do të kryhet asnjë negociatë me Ofertuesin në lidhje me ofertën e tij. Megjithatë, Autoriteti shitës mund t'i kërkojë Ofertuesit të sqarojë ofertën e tij, pa bërë asnjë ndryshim në thelbin e saj.

Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

- 5.2 Autoriteti Shitës korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave.
- 5.3 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Shitës, sipas shembujve të mëposhtme:
- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shumat në fjalë lidhet me një gabim aritmetik,
 - përveç kontratave me shuma të mëdha, nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shumat në total,
 - nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet.
- 5.4 Autoriteti Shitës e konsideron një ofertë si të pranueshme, nëse ajo i plotëson kërkesat e parashikuara në njoftimin e kontratës dhe në DA. Pavarësisht nga sa u tha më lart, Autoriteti Shitës ka të drejtë ta quajë ofertën të pranueshme, nëse:
- (i) ajo përmban ndonjë gabim ose pakujdesi që mund të korrigjohen pa ndryshuar asnjë kusht ose aspekt material të kësaj oferte, ose që nuk ndikojnë në konkurrencë, ose
 - (ii) ajo përmban vetëm devijime të vogla që nuk e ndryshojnë materialisht ose që nuk lindin si pasojë e karakteristikave, kushteve dhe kërkesave të tjera të paraqitura në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e ankandit; megjithatë, me kusht që çdo ndryshim i fillë të matet sa më mirë të jetë e mundur, dhe të merret në konsideratë siç duhet gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave.
- 5.5 Sa herë që refuzohet një ofertë ose s'kualifikohet një ofertues, autoriteti shitës informon ofertuesin e interesuar mbi arsyen/t e skualifikimit ose refuzimit. Formulari i njoftimit gjendet në Shtojcën 6 të DA.

6. PROCEDURA E ANKIMIT

- 6.1 Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të ankandit, kur gjykon se një vendim i autoritetit shitës është marrë në kundërshtim me këtë ligj apo me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- 6.2. Ankesa i paraqitet me shkrim autoritetit shitës brenda 5 ditëve pune nga data kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.
- 6.3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti shitës pezullon vazhdimin e procedurës së ankandit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni.
- 6.4. Autoriteti shitës shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 5 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.
- 6.5. Nëse autoriteti shitës nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Agjencinë e Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti shitës, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti shitës. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet edhe autoritetit shitës.
- 6.6. Ankesa në Agjencinë e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Agjencia e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, me Kodin e Procedurave Administrative dhe me rregullat e ankandit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme.
- 6.7. Me marrjen e ankesës me shkrim të ankimuesit, autoriteti shitës pezullon procedurat e ankandit, me përjashtim të rasteve kur Agjencia e Prokurimit Publik vendos ndryshe, në përputhje me pikën 2 të nenit 43 të këtij ligji.
- 6.8. Me marrjen e ankesës me shkrim të ankimuesit, Agjencia e Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim brenda 5 ditëve. Kur për shqyrtimin e ankesës kërkohet informacion nga autoriteti shitës, agjencia përgjigjet me shkrim, sipas përcaktimit në rregullat e ankandit publik, por jo më vonë se 20 ditë. www.app.gov.al.

7. NËNSHKRIMI I KONTRATËS

- 7.1. Autoriteti shitës dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë kontratën brenda 10 ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike. Kjo periudhë nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin e ankandit ose në dokumentet e ankandit.
- 7.2. Kontrata hyn në fuqi kur nënshkruhet nga fituesi i ankandit dhe nga autoriteti shitës.
- 7.3. Kur fituesi i ankandit nuk arrin të nënshkruajë kontratën ose nuk bën sigurimin e kontratës, nëse një gjë e tillë kërkohet, autoriteti shitës bën konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertuesve që kanë mbetur, nëse diferenca ndërmjet ofertës së klasifikuar në vend të parë dhe asaj të klasifikuar në vend të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës. Kjo nuk cenon të drejtën e autoritetit shitës për të refuzuar të gjitha ofertat e mbetura dhe për të anuluar procedurën e ankandit.

**Sigurimi për ekzekutimin e kontratës
(OPSION)**

- 7.4 Autoriteti Shites kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, që është i bashkangjitur si Shtojca 12 e DA, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.
- 7.5 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
- i. garanci bankare e pakushtëzuar,
 - ii. garanci sigurimi,
- 7.6 Në pajtim me Rregullat për AP, pas nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Shitës dërgon një njoftim në APP për Publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Kushtet e kontratës

- 7.7 Autoriteti Shitës do të firmosë me Fituesin e ankandit të shpallur nga Komisioni i Ankandit.

8. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DA:

- Shtojca 1: Formulari i Njoftimit të Ankandit
Shtojca 2: Formulari i Ftesës për Ofertë
Shtojca 3: Formulari i Ofertës
Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës
Shtojca 5: Kriteret për pjesëmarrje, kualifikim dhe vlerësim të ofertës
Shtojca 6: Formulari për Njoftimin e Skualifikimit
Shtojca 7: Formulari i Njoftimit të Fituesit
Shtojca 8: Formulari i Sigurimit të Kontratës
Shtojca 9: Formulari i Ankesës
Shtojca 10: Specifikimet Teknike
Shtojca 11: Sasia dhe grafiku i lëvrimit
Shtojca 12: Kushtet e përgjithshme Mallrat – Ankand i Hapur
Shtojca 13: Kushtet e veçanta

Shtojca 3.

[*Letër me kokë e ofertuesit*]

FORMULARI I OFERTËS

[*Ref. ...*]

[*Data*]

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit shitës*]

* * *

Procedura e ankandit (*nëse zbatohet*): [*referenca e dosjes, përcaktuar sipas autoritetit shitës*]

Pëishkrim i shkurtër i procedurës së ankandit [*lloji i procedurës dhe objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimit Publik [*Data*] [*Numri*]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Kemi shqyrtuar dokumentet e ankandit për këtë procedurë dhe pranojmë, pa rezerva e përjashtime, kërkesat, afatet kohore dhe kushtet, e shprehura në këto dokumente;
2. Ne i përmbushim të gjitha kërkesat ligjore, të përcaktuara në dokumentet e ankandit, dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumenta, të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë;
(*në rast të procedurës së kufizuar ose me negociim, për fazën e kualifikimit*)
3. Ne shprehim interes për të marrë pjesë në procedurë, në rast përzgjedhjeje nga autoriteti shitës;
(*në rastin e ankandit të hapur/procedurës së kufizuar ose me negociim gjatë fazës së ofertimit dhe me kriterin e çmimit më të lartë*)
4. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; pa TVSH;
5. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; me TVSH
(*në rast të ankandit të hapur/procedurës së kufizuar ose me negociim gjatë fazës së ofertimit dhe me kriterin e ofertës me avantazhe më të mëdha ekonomike*)
6. Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në dokumentet e ankandit;
7. Ne kemi bërë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e ankandit;

8. Ne autorizojmë autoritetin shitës të verifikojë informacionin/ dokumentet, që i bashkëlidhen kësaj oferte.
9. Pajtohem për te firmosur kontratën nëse shpallej fitues.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 4.

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Ref. ...]

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit shites]

Në emer të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e ankandit (nëse zbatohet): [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: [lloji i procedurës dhe objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Prokurimit Publik [Data] [Numri]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga kandidati i lartpërmendur bleres.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit shites] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e ankandit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së blerjes kur autoriteti shites e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e ankandit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5

1. KRITERET PËR PJESEMARRJE, KUALIFIKIM DHE VLERESIM TE OFERTES

Autoriteti shitës kualifikon në procedurat e ankandit çdo kandidat ose ofertues vetëm kur paraqet:

- a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet standarde të ankandit;
- b) vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- c) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
- ç) ne rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e te cilit depozitohet pranë komisionit të ankandit

2. Autoriteti shitës, kur kërkohet informacion për ofertuesin rezident në një shtet të huaj, mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve përkatëse.

Skualifikimi i ofertuesve

1. Autoriteti shitës skualifikon në çdo kohë kandidatët ose ofertuesit, që paraqesin të dhëna të rreme ose një dokument të falsifikuar, për qëllime kualifikimi, gjatë një procedure ankandi. Autoriteti shitës në këtë rast i kërkon Agjencisë së Prokurimit Publik përjashtimin nga ankandet publike të ofertuesit që ka përdorur këto të dhëna apo dokumente.
2. Autoriteti shitës skualifikon çdo kandidat apo ofertues, ndaj të cilit është marrë vendimi i përjashtimit nga procedurat e ankandit publik, sipas legjislacionit përkatës.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet shitese. Këto kritere duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Për të vërtetuar se Kandidatet Blerës janë të kualifikuar, ofertuesi duhet të paraqesë:

(të plotësohet nga autoriteti shitës, në pajtim me kërkesat e parashikuara në Seksionin 4 të DA)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 6

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të ankandit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin për Prokurimet Publike, nr. 9874 datë 14.02.2008, i njohur si LAP”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u [s’kualifikuat] [eliminuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme [*shënoni kutinë e duhur*]:

[subjekti juaj] [drejtuesi juaj ekzekutiv]

- mori pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës, ose dosjen e ankandit, ose pjesë të tij, që u përdorën nga autoriteti kontraktor
- mori asistencë të paligjshme në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së ankandit, ose një pjesë të saj

[subjekti juaj]

- Është gjykuar nga një gjykatë që gëzon juridiksionin kompetent se ka kryer një shkelje kriminale ose civile, që përfshin praktikën korruptive, pastrimin e parave, organizimin kriminal ose aktivitetet e përshkuara në Nenin 15 të LAP, në ligjet ose rregullat e zbatueshme në Shqipëri, ose sipas marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare;
- Një gjykatë me juridiksion kompetent ka vendosur se ka kryer një veprim mashtrimi ose një veprim të njëvlershëm me mashtrimin;
- Është dënuar nga një gjykatë me juridiksion kompetent, për sjellje të gabuar profesionale;
- Është në ndjekje penale për një nga veprat penale të përshkuara në nenin 15 të LPP;

¹ Ky njoftim i adresohet ofertuesve i) që janë s’kualifikuar në bazë të Nenit 45, 46 dhe 47 të LPP; ii) oferta e të cilëve është refuzuar për shkak se ata nuk arritën të plotësonin kërkesën për sigurimin e ofertës.

- ka falimentuar, aktiviteti është marrë nën administrimin e gjykatës,
- është nën procedurën e deklarimit të falimentimit, sipas një urdhri për likuidim të detyruar ose administrim nga gjykata, ose sipas një marrëveshjeje me kreditorët, ose sipas procedurave të ngjashme;
- është dënuar me vendim të formës së prerë për shkelje lidhur me sjelljen profesionale;

- nuk ka paguar kontributet e sigurimit shoqëror, në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;
- nuk ka përmbushur detyrimet lidhur me pagimin e tatimeve, në përputhje me Ligjin Shqiptar ose me dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;

Nuk arritët të paraqisni:

- Certifikatat ose vërtetimet e kërkuara që tregojnë se ju nuk jeni në kushtet e Nenit 45 të LPP,
- Një certifikatë, dokument ose vërtetime të tjera të mjaftueshme që kërkohen nga autoriteti shites sipas Nenit 46 të LPP dhe (*seksionet përkatëse të DT*), me qëllim verifikimin e përshtatshmërisë suaj profesionale;
- Autoriteti Kontraktor ka vendosur se ju keni dorëzuar dokumente që përmbajnë informacion të rremë ose dokumenta të falsifikuar, me qëllim kualifikimi;

- Oferta juaj [nuk i përgjigjet kërkesave] [është e parregullt] [është anomalisht e ulët];

- Nuk arritët të plotësonit kërkesat për sigurimin e ofertës;

- (ndonjë shkak tjetër përvec atyre më sipër)

JUSTIFIKIMI

[Jeni s'kualifikuar] [oferta juaj u refuzua] për shkak të këtyre arsyeve, si më poshtë:

[Shënoni arsyet e hollësishme për s'kualifikimin ose refuzimin e ofertës në fjalë]

Nëse mendoni se Autoriteti Shtetës ka shkelur LAP ose RAP gjatë procedurës së ankandit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LAP dhe seksionin 6 të DT.

Edhe pse nuk mundëm të bashkëpunonim në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të shitjeve nëpërmjet ankandit publik.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 7

[Autoriteti Shites]
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Ref. ...]

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e ankandit: [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kanë qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjale)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjale)

Etj. _____

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë
meposhtme:

numri i NIPT-it Perkatesisht per arsyet e

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

Shtojca 8

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

[Ref. ...]

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emer të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit (nëse zbatohet): [referenca e dosjes, përcaktuar sipas autoritetit kontraktor]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [lloji i procedurës dhe objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Prokurimit Publik [Data] [Numri]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve] në një shumë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [emri i autoritetit kontraktor]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

Shtojca 9

FORMULARI I ANKESËS PËR ANKANDIN PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti Shites

Ankesë drejtuar: Agjencia e Prokurimit Publik

(Shënoni një nga kutitë)

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqëror).

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Email

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Seksioni II. Informacion për Procedurën

1. Numër Identifikimi

Plotësoni numrin e references te përcaktuar ne dokumentet e ankandit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për ankandin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).

2. Autoriteti Shites

Emri i autoritetit shites që administron procesin e ankandit publik

3. Vlera e shpallur ne Ankand

(shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. Objekti i Ankandit

Përshkrim i shkurtër i objektevee/mallrave/shërbimeve që shiten.

5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

6. Data e shpalljes se fituesit

Data (viti/muaji/dita)

Data (viti/rmuaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore e Ankesës

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

Seksioni IV. Kundërshtimi Paraprak ndaj Autoritetit Kontraktor

Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejtpërdrejt autoritetit shites. Bashkangjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.

1. Keni bërë ndonjë kundërshtim të tillë? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (psh, me shkrim, nepernjët faksit, etj).

Po Jo

2. Autoriteti shites Pranë të Cilit është bërë Kundërshtimi
Emri i autoritetit shites.

Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi.

3. Natyra e Masës së Kërkuar Korrigjuese
Çfarë mase korrigjuese kërkoni?

4. Lista e Shtojcave

Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e ankandit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë. Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë: Agjencisë së Prokurimit Publik.

Një kopje e kësaj ankese duhet t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit shites.

Nr. Faks:

E-mail:

Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit

Shtojca 10

SPECIFIKIMET TEKNIKE

I. Parathënie

Ky dokument është përgatitur bazuar në informacione të publikuara nga Administratorët dhe Aksionerët e klubit. Qëllimi i këtij dokumenti është informimi i blerësve të mundshëm për gjendjen e sotme dhe mundësitë e ardhshme të "K.F Oriku". Natyra e të dhënave dhe komenteve përkatëse është informuese dhe nuk duhet të konsiderohet këshillë apo rekomandim për të arritur qëllime të caktuara.

II. Qëllimi

Bazuar në autoritetin ligjor, Bashkia Vlorë, e përfaqësuar nga kryetari ofron për shitje ..% të kapitalit të saj në shoqërinë "K.F Oriku" sh.a.

Për këtë qëllim, Bashkia, e ndihmuar edhe nga këshilltari/këshilltarët e kontraktuar për procesin e shitjes, synon që të rrisë interesin e investuesve kombëtarë me reputacion të lartë.

Informacioni i mëposhtëm do të ndihmojë palët e interesuara për përgatitjen e ofertave. Të gjitha komunikimet ose pyetjet duhet të drejtohen tek njësia e prokurimit të Bashkisë.

III. Arsyet kryesore për këtë investim

1. Interesi për pjesëmarrje të investimeve private në futboll është rritur në itet e fundit me rritjen e të ardhurave nga të drejtat televizive, reklamat, tifozeria, mediat, trofetë, sponsorizimet.

2. Eksperiencat doimnuese tregojnë se investimet në klubet e futbollit, përveç synimit për rritjen e fitimeve dhe kapitalit e aksionerëve, motivojnë edhe qëllimin e përfshirjes sociale dhe kontributeve për komunitetin ku ushtrohet biznesi apo ka interesa të caktuara.

3. Tregu privat i futbollit është i ri dhe dinamik, ku klubet private, po shënojnë rritje në cilësinë dhe tregun financiar të futbollit.

4. Federata e futbollit ka përmirëuar dukshëm standardet dhe rregullat për zhvillimin dhe mbikqyrjen e sportit të futbollit.

5. Ndryshimet e fundit miratuar me Ligjin Nr.105/2020 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.79/2017 "Për Sportin", përcaktojnë detyrimin që institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregëtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin ato në shitje, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

IV. Tregu i Futbollit në Shqipëri

Tregu privat i futbollit është i ri dhe dinamik ku klubet private po shënojnë rritje në cilësinë dhe treguesit financiarë të futbollit. Klubet e futbollit të Ligës Superiore zotërohen me kuota të ndryshme nga Bashkitë dhe kompanitë private. Në disa raste klubet janë themeluar si shoqëri tregëtare dhe Bashkitë kanë blerë kuota më vonë duke paguar kontribute financiare. Klubet që janë në zotërim të plotë ose dominues nga bashkitë rezultojnë me vlerë negative të kapitalit ndërsa klubet e zotëruara tërësisht ose me shumicë nga aksionerë privtë kanë kapital pozitiv, i cili varion në shumicën e tyre.

V.Klubi i Futbollit “Oriku” ushtron veprimtarinë si Shoqëri Tregëtare Aksionere

“K.F Oriku” sh.a është krijuar dhe regjistruar në QKB me NIPT L36521202N, me seli në adresën Orikum, Lagja “1 Maj”, Rruga “Bulvardi Princesha Rugjine” Vlorë, me aktivitet të veprimtarisë : Organizimi i aktiviteteve sportive të futbollit: Krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në gara sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit, Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të futbollit dhe të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe ndërkombëtare. Futja në tregun e lojrave për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit. Aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë dhe bashkisë.

Shoqëria “K.F Oriku” sh.a, Vlorë është regjistruar si shoqëri në datën 21.03.2013, me kapital themeltar prej 4.100.000 lekë, i ndarë në 4.100,00 aksione me vlerë nominale 1.000 lekë secila, Aksioner është 100% Bashkia Vlorë.

Bilanci dhe pasqyrat financiare janë të auditura dhe të standartizuara me kërkesat e ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. Bashkia Vlorë ka realizuar vlerësimin e Klubit me shoqëri audituese të licensuar. Dokumentat me të dhënat e pasqyrave financiare dhe raportet përkatëse të auditimit gjenden të publikuara në faqen në ëeb www.bashkiavlore.gov.al

- Të ardhurat e Klubit Oriku
- Të ardhura nga biletat, e drejta televizive, shitja e lojtarëve, academia e futbollit, grantet, reklamat dhe sponsorizimet që janë rritur nga viti në vit.

Vitet	Te ardhurat			Totali
	Grandet	Sponsorizim	Te ardhura te veta	
2013	2.729.260	0	0	2.729.260
2014	6.000.000	0	0	6.000.000
2015	8.391.318	0	0	8.391.318
2016	8.000.000	25,000	90.292	8.115.292
2017	7.600.000	133.575	0	7.733.575
2018	11.900.000	810.000	0	12.710.000
2019	11.300.000	1.556.070	0	12.856.070
2020	13.600.000	1.246.487	75.000	14.921.487
2021	13.000.000	720.000	0	13.720.000
2022	0	8.517.400	0	8.517.400
2023	5.000.000	3.121.551	0	8.121.551
Totali	87.520.578	16.130.083	165.292	103.815.953

Shtojca 11

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e aksioneve që shitet:

Bashkia Vlorë shet me ankand 100% të aksioneve të saj në “K.F Oriku” sh.a me vlerë fillestare 12.658.000 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjete e tetë mijë) Lekë.

Afatet e lëvrimit:

Transferimi i aksioneve nga Bashkia Vlorë tek kandidati blerës fitues do të bëhet jo më vonë se 5 ditë nga data e hartimit të aktit noterial të shitblerjes së aksioneve, por me kushtin që kandidati blerës/fitues të ketë paguar në favor të Bashkisë Vlorë vlerën sipas cmimit fitues të përcaktuar pas përfundimit të procedurave të ankandit publik.

Shtojca 12.

KUSHTET E PËRGJITHSHME
Mallrat – Ankand i Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen/shitjen e Mallrave/objekteve/ me anë të ankandit të hapur.
- 1.2 Ligji për Ankandin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e ankandit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Ankandin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon ankandin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Ankandin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit shites dhe ofertuesit fitues që përbëhet nga Dokumentat e ankandit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet autoritetit shites sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot, dhe rrisqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga Autoriteti shites tek Ofertuesi fitues.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti shites” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Ofertues fitues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat.

- 2.7 “palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gazshme.
- 2.9 “Shërbimet në Lidhje me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose te paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet në Lidhje me to që Autoriteti shites do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarte Teknike” do të thote specififikimet e aprovuara nga një trup i posacëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Ankandit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Ofertuesi fitues ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Ankandin Publik.
- 4.2 Ofertuesi fitues nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të ankandit.
- 4.3 Ofertuesi fitues duhet të lejojë Autoritetin shites të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti shites.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Ofertuesi fitues dhe Autoriteti shites duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Autoriteti Shites gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Ofertuesi fitues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Autoriteti shites, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Ofertuesi fitues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet,

skicimet, specififikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Autoriteti shites gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake më shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Autoriteti shites duhet të sigurojë Ofertuesin fitues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmeria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Autoriteti shites duhet të dorezojë Mallrat me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, në se ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posacem të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në pajtim me kontratën në se ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Në se shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi duhet të dorezojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përshtatshmeria e Mallrave me Standartet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standarteve Teknike të parashikuara në specififikimet teknike. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet perkatese ose në Standartet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktues.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër të kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standart Teknik perkates në specififikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike ndërkombëtare të tanishme. Nëse nuk egzistojnë Standarte Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike perkatese Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk do të jetë përgjegjës për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktues me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi nuk mban përgjegjësi për defekte të pronës (Mallrave) për të cilat ofertuesi fitues ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit

kur defektet kane te bejne me cilesine e Mallrave te specifikuar sipas kontrates ose perfaqsimin e reklames se shitesit.

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Në se kontrata parashikon, Autoriteti shites duhet të përfshijë me Mallrat e dhëna një sasi pjesësh këmbimi, në akordim me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë perkatese të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Autoriteti shites duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në oferten e tij dhe të barabartë me jetgjatësinë e përdorimit të Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Autoriteti shites duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në pajtim me kontratën në se ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, në se mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Ofertuesi fitues duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Ofertuesi fitues brenda kushteve të çmimit të kontratës
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti shites ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.

Neni 13: Kushtet e Dorëzimit

- 13.1 Autoriteti shites është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit me përjashtim kur autoriteti shites përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.
- 13.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.
- 13.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve në Lidhje me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.
- 13.4 Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozitë të kontratës.
- 13.5 Autoriteti shites është i detyruar t'i japi ofertuesit fitues njoftim të arsyeshëm për dorëzimin e Mallrave përpara arritjes së tyre.

Neni 14 Transportimi i Mallrave

Neni 15: Siguracioni

15.1 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, Autoriteti shites duhet të sigurojë se Mallrat që do dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit gjatë transportit, magazinimit ose dorëzimit të tyre.

Neni 16: Egzaminimi dhe Pranimi i Mallrave

16.1 Përpara pranimit, Ofertuesi fitues ka të drejtë të egzaminojë, inspektojë dhe testojë Mallrat. Ky aktivitet duhet të bëhet menjehere pas dorëzimit të Mallrave. Autoriteti shites ka të drejtë të marrë pjesë në këtë aktivitet dhe të shqyrtojë raportet e aktivitetit të përgatitura nga ofertuesi fitues ose agjentët e tij.

16.2 Ofertuesi fitues duhet të pranojë ose refuzojë Mallrat menjehere pas dorëzimit dhe duhet t'i japi Autoriteti shites njoftim me shkrim për veprimin e tij për të pranuar ose refuzuar Mallrat.

Neni 17: Garancitë

17.1 Shitësi mban përgjegjësi për çdo defekt ose mospërputhje që egziston në momentin kur rrisku kaloi tek Autoriteti Kontraktor, edhe kur defekti shfaqet pas këtij momenti.

17.2 Shitësi mban përgjegjësi për mospërputhjen që verifikohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm dhe që vjen nga mospërmbushja e ndonjë detyrimi, duke përfshirë garancinë që Mallrat duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e tyre të zakonshëm dhe specifik për një periudhë të caktuar kohe, ose se ato do të ruajnë cilësitë dhe karakteristikat e caktuara.

17.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë ose nga ligji, Ofertuesi fitues humbet të drejtën e tij për të kundërshtuar për të metat e sendit nëse ai nuk i denoncon ato të shitësi duke specifikuar natyrën e tyre, brenda dhjetë ditësh nga zbulimi i tyre.

17.4 Pas marrjes së këtij njoftimi, Autoriteti shites duhet të riparojë menjehere ose të zëvendësojë Mallrat defektive ose pjesët e tyre gratis për ofertuesin fitues.

Neni 18: Çmimi i Kontratës

18.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Ofertuesit fitues dhe i pranuar nga Autoriteti shites.

18.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, çmimi i kontratës përfshin kostot dhe tarifën, duke përfshirë taksat dhe tarifën doganore të lidhura me dorëzimin e Mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, instalimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhezimet, manualët dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar dhe të nevojshme për përdorim të rregullt, mirmbajtje dhe riparime të Mallrave. Çmimi i taksave dhe tarifave duhet të përcaktohet sipas ligjeve në fuqi 28 ditë para hapjes së ofertave.

Neni 19: Afatet e Pagesës

19.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.

- 19.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për botimin të njoftimit të kontratës.
- 19.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për Mallrat do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë pranuar Mallrat ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë.
- 19.4 Data e pagesës do të jete dita që fondet xhirohen ne llogarine e Autoritetit shites.

Neni 20: Vonesa në Bërjen e Pagesës

- 20.1 Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bere llogaritja e tyre.
- 20.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin te provoje ndonje dem. Nëse kreditori provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 21: Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 21.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa ofertuesi fitues është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 22: Forca Madhore

- 22.1 Ofertuesi fitues nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontrates, dëmeve të likuiduara ose ndërprejen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 22.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Ofertuesit fitues mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit shites qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 22.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin shites. Me përjashtim kur Autoriteti shites jep direktiva të ndryshme, Ofertuesi fitues duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 23: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 23.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Ofertuesi fitues duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

- 23.2 Autoriteti shites do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 23.3 Autoriteti shites mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se ofertuesi fitues ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Ofertuesi fitues duhet të njoftojë me përpikmëri Autoritetin shites me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar për marrjen në dorëzim. Autoriteti shites duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti shites është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga të dy palët.

Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

- 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore::
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës. .
 - Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet

- 25.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së ofertuesit fitues.
- 25.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i ofertuesit fitues dhe Autoritetit shites.
- 25.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 26: Ndërprerja për Mosplotësim

- 26.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- Ofertuesi fitues dështon në marrjen në dorëzim të Mallrave brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - Ofertuesi fitues dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 26.2 Autoriteti shites duhet t'i japë Ofertuesit fitues njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japë Ofertuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 27: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

- 27.1 Autoriteti shites mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse ofertuesi fitues falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

27.2 Autoriteti shites duhet t'i japi ofertuesi fitues njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 28: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

28.1 Autoriteti shites mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

28.2 Autoriteti shites duhet t'i japi ofertuesit fitues lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 29: Sigurimi i Kontrates

29.1 Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, ofertuesi fitues duhet t'i japi Autoriteti shites garancinë e sigurimit te kontrates në shumën dhe formën e pranueshme siç specifikohet në kontratë. Deshtimi për të dhene sigurimin e kontrates në formën dhe në shumën e kërkuar brenda 30 ditëve do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe sekuestrimin e sigurimit te ofertes të Ofertuesit fitues.

30.1 Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit shites si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Ofertuesit fitues në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

30.2 Garancia e sigurimit te kontrates do t'i kthehet Ofertuesit fitues jo më vonë se 30 ditë pas datës së pranimit të Mallrave. Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontrates.

Neni 30: Baza Ligjore

30.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 31: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

31.1 Palet duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

31.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së mosmarrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 32: Përfaqsimi i Palëve

32.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

32.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

32.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta, rast në të cilin njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqsesit.

Neni 33: Lajmërimet

33.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

33.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 34: Llogaritja e Afateve

34.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Shtojca 13

**KUSHTET E VEÇANTA
Mallrat – Ankand i Hapur**

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast konflikti, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

- 1.1 Autoriteti shites është
- 1.2 Ofertuesi fitues është

Neni 2: Sigurimi i Kontrates

- 2.1 Sigurimi i Kontrates në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga ofertuesi fitues për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i Kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë ofertuesi fitues sipas formularit të mëposhtëm:

Neni 3: Fillimi i Zbatimit

- 3.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë më _____. Nëse data nuk është e përcaktuar, zbatimi do të fillojë në datën që ofertuesi fitues nënshkruan formularin e kontratës.

Neni 4: Inspektimet dhe Testimet

- 4.1 Inspektimet dhe testimet para pranimit të Mallrave do të bëhen:

Neni 5: Kushtet e Dorëzimit

- 5.1 Data (t) dhe vendi (et) i dorëzimit të Mallrave dhe pjesëve të kembimit do të bëhet sipas Graffikut të Levrimin të parashikuar në këtë kontratë.
- 5.2 Autoriteti shites duhet të njoftojë ofertuesi fitues _____ ditë para çdo dorëzimi të Mallrave.

5.3 Lajmërimi i dorëzimit duhet të bëhet me shkrim, faks, poste, e-mail etj, tek:

Neni 6: Kushtet e Pagesës

- 6.1 Pagesa e Mallrave duhet bërë brenda _____ ditëve nga data e dorëzimit të Mallrave ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim të pagesës, sado vone që të vije. Nëse nuk është specifikuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.
- 6.2 Monedha e pagesës do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 7. Pagesa Paraprake

- 7.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse nuk është specifikuar, Autoriteti shites nuk do të marrë pagesë paraprake.
- 7.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda _____ ditëve nga marrja e sigurimit të kontratës.
- 7.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Autoriteti shites sipas formulës së mëposhtme:


Neni 8. Shërbimet në Lidhje me to

- 8.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së Shërbimeve të Lidhura

Neni 9. Zbritja e garancisë së kontratës

- 9.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë:

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.



KEI-AL
A U D I T I N G


Auditing & Related Services,
Accounting, Tax Advice and
Business

RAPORTI i VLERËSIMIT

K.F.ORIKU SHA

Data efektive e vlerësimit është 31 dhjetor 2023

Data e raportimit është 25 korrik 2024



KEI-AL
A U D I T I N G

Auditing & Related Services,
Accounting, Tax Advice and
Business

RAPORT I VLERËSIMIT K.F.ORIKU Sh.A

Vlorë më, 25/07/2024

BASHKIA VLORË

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë" Vlore, 9400. Shqipëri.

Të nderuar zotërinj,

Bazuar në kontratën e lidhur midis palëve, ne kryem vlerësimin e biznesit të shoqërisë Shoqërisë "K.F.Oriku" Sh.A e cila është krijuar dhe regjistruar në QKB me NIPT L36521202N , me seli në adresën Orikum, Lagjja "1 Maji", Rruga "Bulevardi Princesha Rugjine " Vlore, me aktivitetet të veprimtarisë : *Organizimi i aktiviteteve sportive te futbollit: Krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesemarrja ne gara sportive te organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit, Aderimi dhe regjistrimi si klub ne Federaten Shqiptare te Futbollit dhe ne te gjitha llojet e aktiviteteve te futbollit kombetare dhe nderkombetare . Futja ne tregun e lojrave per te blere lojtare sipas nevojave te ekipit. Aktivitete te tjera ne fushen e futbollit per interesat e shoqerise dhe bashkise .*

Shoqëria "KF Oriku" sha, Vlore eshte regjistruar si shoqeri ne daten 21.03.2013, me kapital themeltar prej 4.100.000 leke , i ndare ne 4.100,00 aksione me vlere nominale 1.000 leke secila , Aksioner eshte 100% Bashkia Vlorë . *(Extrati historik i QKR-se).*

Qëllimi i kësaj detyre është të ofrojë shërbime konsulence profesionale për të përcaktuar një opinion për vlerën e drejtë të aseteve në biznesin e shoqërisë "K.F Oriku" sha , për qëllime të parashikuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë në formularin nr. 3 e procedurës së prokurimit publik me vlerë të vogël me objekt: *Vlerësimi i aseteve të Klubeve të Futbollit "Flamurtari Futboll Club" dhe "K.F. Oriku" për privatizim, të zhvilluar në datën*

14.03.2024 , ora 09,00 në Bashkinë Vlorë. Asnjë qëllim tjetër nuk synohet dhe nuk duhet të konkludohet në këtë raport.

Data efektive e vlerësimit është bazuar në Pasqyrat Financiare të Shoqërisë "K.F.Orikum" sh.a të datës 31.12.2023 të hartuar nga Drejtimi i Shoqërisë dhe të dërguar nga ana e Bashkisë Vlorë me shkresën zyrtare nr 9605/1 datë, 26.06.2024.

Rezultatet e punës së vlerësimit, të përmbledhura më poshtë, ofrojnë një tregues se çfarë mund të jetë i përgatitur të paguajë një blerës i mundshëm për Shoqërinë KF Oriku sha me synimin për të vazhduar biznesin ekzistues.

Shoqëria audituese KEI-AL Auditing ka përgatitur këtë Raport Vlerësimi në përputhje me procedurat dhe me qëllimin e punës të rënë dakord në kontratën tonë nr 5905 të datës 18.04.2024 dhe Standardet Ndërkombëtare të Vlerësimit 2023. Bazuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Vlorë është kërkuar të ofrojë një analizë vlerësimi, për të përcaktuar vlerën e aseteve të shoqërisë më 31 dhjetor 2023. Qëllimi i vetëm i analizës së vlerësimit ishte vlerësimi i aseteve të Klubeve të Futbollit "Flamurtari Futboll Club" dhe "K.F. Oriku" për privatizim dhe asnjë qëllim tjetër nuk synohet dhe nuk duhet të konkludohet.

Objektivi i vlerësimit është të shprehë një opinion të pavarur mbi vlerën e drejtë të shoqërisë, mbi bazën e vazhdimësisë, më 31 dhjetor 2023.

Vlera e drejtë SNRF 13 përkufizohet njësoj si vlera e tregut, dmth si "shuma e vlerësuar për të cilën një aktiv ose pasiv duhet të këmbehet në datën e vlerësimit midis një blerësi të gatshëm dhe një shitësi të gatshëm në një transaksion të barabartë pas marketingut të duhur dhe kur palët kishin vepruar secila me dijeni, me maturi dhe pa detyrim".

Një aplikim i zakonshëm i *vlerës së drejtë* është për vlerësimin e çmimit që është i drejtë për aksionet në një biznes, ku sinergjitë e veçanta midis dy palëve specifike mund të nënkuptojnë se çmimi që është i drejtë midis tyre është i ndryshëm nga çmimi që mund të merret në gjerësi tregu.

Përfundimi i vlerës së drejtë të arritur është një vlerësim i arsyeshëm i çmimit me të cilin prona mund të ndryshojë duart ndërmjet dy palëve të gatshme. Duhet të kuptohet se çmimi aktual i paguar në një transaksion që përfshin këtë pronë mund të ndryshojë nga vlera e vlerësuar për shkak të faktorëve të tillë si motivimi i palëve, aftësitë negociuese të palëve, struktura e transaksionit (p.sh. struktura e financimit) , kostot ose përfitimet që mund të mos reflektohen në rezultatet e paraqitura më poshtë ose në faktorë të tjerë unikë për transaksionin.

Vlerësimi ynë i shoqërisë përfaqëson perceptimin tonë duke marrë parasysh vlerën reale të shoqërisë. Ai nuk përfaqëson vlerën e shoqërisë siç mund të merret nga investitorët ose nëpërmjet shitjes ose transferimit të shoqërisë në një shoqëri tjetër.

Rezultatet nuk duhet të interpretohen si shuma që një blerës i mundshëm duhet ose do të paguajë përfundimisht. Çmimi përfundimtar do të pasqyrojë fuqinë relative të negociatave dhe termat dhe kushtet e negociuara ndërmjet palëve përkatëse, kostot ose përfitimet të cilat mund të mos reflektohen në rezultatet e paraqitura më poshtë në raport.

Vlerësimi i shoqërisë është kryer në bazë të parimit të vazhdimësisë, dmth. nën supozimin se menaxhmenti i shoqërisë do të kryejë vetëm ato strategji financiare dhe operacionale që do t'i mundësojnë shoqërisë të operojë dhe të zhvillohet në të ardhmen.

Vlerësimi i kompanisë është kryer në përputhje me metodologjitë e vlerësimit të njohura ndërkombëtarisht. Për qëllime të vlerësimit të Kompanisë, ekipi ynë i pavarur i vlerësuesve përdori metodologji të ndryshme vlerësimi të cilat paraqitën në analizën e këtij raporti.

Vlera e aktiveve afatgjata në përdorim të vazhdueshëm nga shoqëria nuk janë pjesë e vlerësimit në këtë Raporti Vlerësimi për faktin se nuk janë pronë e shoqërisë (nuk ekziston një certifikatë pronësie apo kontratë përdorimi në emër të KF Oriku) . Inventari ekonomik i cili përbëhet nga 24 copë karrige kinemaje, 2 copë tavolina 1 njësi qendrore dhe 1 monitor referuar fletës së inventarit të datës 31 dhjetor 2023 janë pronë NJA Orikum.

Rezultatet e vlerësimit të Shoqërisë “K.F.Oriku” Sh.A janë si më poshtë:

Vlera e Shoqërisë K F ORIKU sh.a	12,658,000 lekë
----------------------------------	-----------------

Vlerësimi ynë bazohet në informacionin dhe të dhënat e ofruara nga Bashkia Vlorë dhe të dhënat e publikuar nga ana e shoqërisë në regjistrin tregtar të biznesit (QKB). Ne u mbështetëm në informacionin e marrë pa hetim shtesë ose konfirmim të pavarur për drejtësi dhe objektivitet të informacionit, dhe shumica e informacionit u mblodh me kërkesën tonë. Një pjesë e dokumentacionit teknik për vlerësimin nuk na është ofruar nga Drejtimi i shoqërisë edhe pse kërkesat tona kanë qënë të vazhdueshme.

Procedurat dhe kërkesat tona nuk përfshinin punë verifikuese ose nuk përbënin një auditim në përputhje me standardet e pranuar përgjithësisht të kontabilitetit. Prandaj, ne nuk shprehim asnjë opinion për asnjë të dhënë financiare apo informacion tjetër të përmendur në këtë raport.

Ne rezervojmë të drejtën të rishikojmë të gjitha llogaritjet e përfshira ose të referuara në raportin tonë dhe, nëse e konsiderojmë të nevojshme, të rishikojmë opinionin tonë në dritën e çdo informacioni ekzistues në datën e vlerësimit që na bëhet i njohur pas datës së

këtij Raporti. Ne nuk kemi asnjë përgjegjësi për të përditësuar Raportin për ngjarjet dhe rrethanat që kanë ndodhur pas datës së këtij Raporti.

Prandaj, ne nuk do të jemi përgjegjës për pasojat financiare ose të tjera që vijnë nga ndonjë gabim ose lëshim nga raporti ynë që rezultojnë nga kufizimet në fushëveprimin e përmendur në këtë raport dhe ju pranoni të na mbani të padëmshëm nga efektet e ndonjë gabimi të tillë ose mosveprim nëse nuk shkaktohet nga keqbesim nga ana jonë.

Ky raport është përgatitur ekskluzivisht për Bashkinë Vlorë dhe nuk duhet të përdoret, të riprodhohet ose të qarkullohet për ndonjë qëllim tjetër, tërësisht ose pjesërisht, pa pëlqimin tonë paraprak me shkrim. Një pëlqim i tillë do të jepet vetëm pas shqyrtimit të plotë të rrethanave në atë kohë.

Kemi kënaqësinë të paraqesim Raportin tonë për vlerësimin e biznesit të K.F. ORIKU Sh.a.

Ju faleminderit !

AUDITUESI LIGJOR

Arqile Mishtaku, AL/EKSP

Licensë nr. 74 datë 31.01.2000

Ortak Angazhimi KEI-AL AUDITING

Bulevardi "Ismail Qemali" P455/1 Ap, 3 Vlorë



Përmbajtja

1	Përmbledhje ekzekutive	7
1.1	<i>Prezantimi</i>	7
1.2	<i>Të dhëna të përgjithshme për shoqërinë K.F Oriku</i>	7
1.3	<i>Objektivi i vlerësimit të shoqërinë K.F Oriku</i>	8
1.4	<i>Fushëveprimi i punës</i>	9
1.5	<i>Burimet e informacionit</i>	9
1.6	<i>Verifikimi fizik i objekteve dhe paisjeve.</i>	16
1.7	<i>Supozime dhe kufizime</i>	16
1.8	<i>Konfidencialiteti</i>	18
1.9	<i>Metodologjia</i>	18
2	Përmbledhja Vlerësimit	21
3	Analiza, ë vlerësimin e shoqërisë dhe rrisin interesin e blerësve të mundshëm	23
3.1	<i>Vlerësimi i aktiveve afatgjata</i>	24
3.2	<i>Vlerësimi i aktiveve afatgjata jo materiale (Emri i mirë)</i>	26
3.3	<i>Vlerësimi i aktiveve rrjedhëse</i>	32
3.4	<i>Vlerësimi i të drejtave të arkëtueshme</i>	32
3.5	<i>Vlerësimi i gjendjeve të inventarit</i>	32
3.6	<i>Vlerësimi i detyrimeve rrjedhëse dhe afatgjata</i>	33
3.7	<i>Kapitali i shoqërisë</i>	34
4	Metoda e kapitaleve neto të shoqërisë	36

1- Përmbledhja ekzekutive

1.1 Prezantimi

Qëllimi i kësaj detyre është të ofrojë shërbime konsulence profesionale për të përcaktuar opinionin për vlerën e drejtë të asetëve në biznesin e shoqërisë "K.F Oriku" sha , për qëllime të parashikuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë në formularin nr. 3 e procedurës së prokurimit publik me vlerë të vogël me objekt: *Vlerësimi i asetëve të Klubeve të Futbollit "Flamurtari Futboll Club" dhe "K.F. Oriku" për privatizim*, të zhvilluar në datën 14.03.2024 , ora 09,00 në Bashkinë Vlorë.

Asnjë qëllim tjetër nuk synohet dhe nuk duhet të konkludohet në këtë raport.

Data efektive e vlerësimit është 31 dhjetor 2023.

Data e raportimit është 25 korrik 2024 .

Shoqëria audituese KEI-AL Auditing ka përgatitur këtë Raport Vlerësimi në përputhje me procedurat dhe me qëllimin e punës të rënë dakord në kontratën tonë nr 5905 të datës 18.04.2024 dhe Standardet Ndërkombëtare të Vlerësimit 2023.

1.2 Të dhëna të përgjithshme për shoqërinë K.F Oriku

Shoqëria "KF Oriku" sh.a (shoqëri anonime), është krijuar më datë 25.02.2013 dhe i regjistruar në QKB në datë 21.03.2013 me NIPT L36521202N , me seli në adresën Orikum Lagjja "1 Maji", Rruga "Bulevardi Princesha Rugjine " Vlore.

Aktiviteti i veprimtarisë : *Organizimi i aktiviteteve sportive të futbollit: Krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në gara sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit, Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe ndërkombëtare . Futja në tregun e lojtrave për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit. Aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë dhe bashkisë .*

Në vitet e fundit, Oriku ka qenë më aktiv, me ambicie për të arritur në Kategorinë Superiore, që është niveli më i lartë i futbollit në Shqipëri. Klubi i futbollit Oriku, i njohur më shpesh si Oriku , është një klub futbollit nga qyteti i Orikumit, pranë qytetit të Vlorës. Ky klub është pjesë e komunitetit sportiv shqiptar dhe ka një histori të përzier në nivelet më të ulëta të futbollit shqiptar. Klubi ka bërë përpjekje për të përmirësuar infrastrukturën dhe ekipin, duke synuar promovimin dhe qëndrueshmërinë në nivelet më të larta të ligës së futbollit në Shqipëri.

K.F. Oriku sha luan ndeshjet e tij si vendas në "Stadiumin e Orikumit" i cili referuar pasqyrave financiare të klubit nga data e themelimit deri ne vitin 2023 rezulton se nuk është pronë e klubit, por e Bashkisë Vlorë. Klubi ka një grup të vogël por të përkushtuar tifozësh që e mbështetin ekipin në ndeshjet e tij. KF Oriku sha është një shembull i klubeve lokale shqiptare që kontribuojnë në zhvillimin e futbollit në nivel kombëtar, duke ofruar mundësi për lojtarët e rinj dhe duke ndihmuar në promovimin e sportit në komunitet. Për vitin 2023-2024 ekipi i futbollit KF Oriku ka luajtur në kategorinë e tretë

Shoqeria "KF Oriku" sha, Vlore eshte regjistruar si shoqeri ne daten 21.03.2013, me kapital themeltar prej 4.100.000 leke , i ndare ne 4.100,00 aksione me vlere nominale 1.000 leke secila.(*Extrati historik i QKR-se*) Aksioner eshte 100% Bashkia Vlore.

Organet e shoqërisë KF Oriku sh.a Vlore janë: a) Asambleja e Përgjithshme; b) Këshilli i Mbikqyrës .

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës jane : Agim Begotaraj; Arsen Belaj dhe Teki Xhemalaj

Shoqeria perfaqesohet nga Administrator i saj z. Muharrem Jazaj me mandat emerimi nga data 08/09/2021 deri ne daten 08/09/2024.

1.3 Objektivi i vlerësimit të shoqërisë K.F Oriku

Kompania është e interesuar të përcaktojë vlerën e drejtë të 100% të Kompanisë mbi bazën pa borxhe, pa para të gatshme - Vlera e ndërmarrjes ("Vlera e shoqërisë") mbi bazën e vazhdimësisë më 31 dhjetor 2023.

Bazuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Vlorë është kërkuar të ofrojë një analizë vlerësimi, për të përcaktuar vlerën e aseteve të shoqërisë më 31 dhjetor 2023. Qëllimi i vetëm i analizës së vlerësimit ishte vlerësimi i aseteve të Klubeve të Futbollit "Flamurtari Futboll Club" dhe "K.F. Oriku" për privatizim dhe asnjë qëllim tjetër nuk synohet dhe nuk duhet të konkludohet.

Objektivi i vlerësimit është të shprehë një opinion të pavarur mbi vlerën e drejtë të Shoqërisë, mbi bazën e vazhdimësisë, më 31 dhjetor 2023.

Vlera e drejtë SNRF 13 përkufizohet njësoj si vlera e tregut, dmth si "shuma e vlerësuar për të cilën një aktiv ose pasiv duhet të këmbehet në datën e vlerësimit midis një blerësi të gatshëm dhe një shitësi të gatshëm në një transaksion të barabartë pas marketingut të duhur dhe kur palët kishin vepruar secila me dijeni, me maturi dhe pa detyrim".

Një aplikim i zakonshëm i *vlerës së drejtë* është për vlerësimin e çmimit që është i drejtë për aksionet në një biznes, ku sinergjitë e veçanta midis dy palëve specifike mund të nënkuptojnë se çmimi që është i drejtë midis tyre është i ndryshëm nga çmimi që mund të merret në gjerësi tregu.

Përfundimi i vlerës së drejtë të arritur është një vlerësim i arsyeshëm i çmimit me të cilin prona mund të ndryshojë duart ndërmjet dy palëve të gatshme. Duhet të kuptohet se çmimi aktual i paguar në një transaksion që përfshin këtë pronë mund të ndryshojë nga vlera e vlerësuar për shkak të faktorëve të tillë si motivimi i palëve, aftësitë negociuese të palëve, struktura e transaksionit (p.sh. struktura e financimit) , kostot ose përfitimet që mund të mos reflektohen në rezultatet e paraqitura më poshtë ose në faktorë të tjerë unikë për transaksionin.

Vlerësimi i shoqërisë është bërë në bazë të parimit të vazhdimësisë, gjerësisht nën supozimin se Menaxhmenti i shoqërisë do të kryejë vetëm ato strategji financiare dhe operacionale që do t'i mundësojnë shoqërisë të operojë dhe të zhvillohet në të ardhmen.

Vlerësimi ynë i shoqërisë përfaqëson perceptimin tonë duke marrë parasysh vlerën reale të shoqërisë. Ai nuk përfaqëson vlerën e shoqërisë siç mund të merret nga investitorët ose nëpërmjet shitjes ose transferimit të shoqërisë në një shoqëri tjetër.

1.4 Fushëveprimi i punës

Në përputhje me qëllimin e punës siç është rënë dakord në kontratën tonë, ne kemi ndërmarrë vlerësimin e vlerës së shoqërisë më 31 dhjetor 2023 në mënyrë që të ofrojmë një vlerësim mbi vlerën e drejtë të shoqërisë .

Në kuadër të punës sonë për përcaktimin e vlerës së drejtë të shoqërisë, ne kemi kryer vlerësimin e asetëve afatgjata të shoqërisë materiale dhe jo materiale , të vlerës së pronës, objekteve dhe pajisjeve si pjesë e metodës së vlerësimit të asetëve neto. Vlera e drejtë e aktiveve afatgjata në përdorim të vazhdueshëm pasqyron vlerën që mund t'i atribuohet çdo aktivi afatgjatë në lidhje me vlerën, veçoritë dhe jetëgjatësinë e tyre të mbetur, duke supozuar vazhdimësinë e funksionimit të tyre në kontekstin aktual të operacionit, vlerësimin e kapitali neto dhe të detyrimeve deri në datën e mbylljes të pasqyrave financiare në 31 dhjetor 2023.

1.5 Burimet e informacionit

Vlerësimi ynë bazohet në informacionin dhe të dhënat e ofruara nga Bashkia Vlorë me shkresë zyrtare nr.9605/1 datë 26.06.2024 e cila përmban pasqyrat financiare të KF Oriku për vitin 2023 sëbashku me shënimet shpjeguese.

Informacioni, të dhënat dhe dokumentet e mëposhtme janë përdorur si bazë për vlerësimin:

- Dokumentet e regjistrimit të kompanisë, statuti, akti themelimit, certifikatat dhe licencat (ekstrati QKB)
- Pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e kapitalit dhe shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023;
- Struktura e vjetërsisë së të arkëtueshmeve nga viti 2019 deri 2023 të publikuar nga thesari i shteti ;
- Struktura e vjetërsisë së të ardhurave (burimi i tyre), shpenzimeve, pasqyrat e pozicionit financiar nga viti 2013 deri 2023 të publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar QKB-së;
- Listat e asetëve (Fleta i Inventarizimi NJA Orikum) më 31 dhjetor 2023;
- Deklaratat tatimore veprimet bankare dhe lispagesat e subjektit për vitin ushtrimor 2023.
- Të dhënat dhe shifrat e marra nga informacionin publik dhe faqja zyrtare të FSHF-së dhe Bashkisë Vlorë.
- Informacioni i dërguar nga Bashkia Vlorë me shkresën nr 9605/1 datë 26.06.2024

Nga hulumtimi dhe veprimet zyrtare ne kemi siguruar informacionin si më poshtë :

- Struktura e vjetërsisë së të ardhurave dhe e shpenzimeve – tabela nr 1

Tabela nr 1

Vitet	Treguesit e Performances				
	Te ardhurat	Shpenzimet	Fitimi Bruto	Tatim fitimi	Fitimi Neto
2013	2,729,260	2,729,260	0	0	0
2014	6,000,000	5,961,063	38,937	25,000	13,937
2015	8,391,318	8,394,427	-3,109	0	-3,109
2016	8,115,292	7,349,083	766,209	114,931	651,278
2017	7,733,575	7,539,226	194,349	29,152	165,197
2018	12,710,000	12,018,696	691,304	103,696	587,608
2019	12,856,700	14,115,991	-1,259,291	0	-1,259,291
2020	14,921,487	15,322,834	-401,347	0	-401,347
2021	13,720,000	12,949,094	770,906	0	770,906
2022	8,517,400	9,706,334	-1,188,934	0	-1,188,934
2023	8,121,551	8,052,494	69,057	0	69,057
Totali	103,816,583	104,138,502	-321,919	272,779	-594,698

- Vlera e subveconit të përfituar nga viti 2019-2023 të pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave - tabela nr 2

Tabela nr 2

Institucion/Buxheta	Përfitues	Deja thënë	Vlera	Data regjistrimit	Data elokutimit	Përshkrimi i fitues
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	05/12/2023	06/12/2023	subvencion futbollit bashkia vlore 2146001 situacini nentor 2023
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	09/11/2023	10/11/2023	subvencion futbollit bashkia vlore 2146001 situacini tetor 2023
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	2,000,000	04/10/2023	05/10/2023	subvencion futbollit bashkia vlore 2146001 situacini shtator 2023
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	15/12/2021	16/12/2021	subvencion futbollit bashkia 2146001 situacioni gusht
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,000,000	24/11/2021	25/11/2021	subvencion futbollit bashkia 2146001 tetor
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	17/11/2021	18/11/2021	subvencion futbollit bashkia 2146001 situacion shtator
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	14/09/2021	15/09/2021	subvencion futbollit bashkia 2146001 situacion korrik
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	500,000	28/07/2021	29/07/2021	subvencion futbollit bashkia 2146001 situacioni maj
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,000,000	28/05/2021	31/05/2021	subvencion futbollit bashkia 2146001 prilli
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	2,000,000	15/04/2021	16/04/2021	subvencion futbollit bashkia 2146001 mars
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	2,000,000	23/03/2021	24/03/2021	subvencion futbollit bashkia 2146001 shkurt
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	2,000,000	12/02/2021	15/02/2021	subvencion futbollit bashkia 2146001 janar
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,000,000	24/11/2020	26/11/2020	subvencion futbollit bashkia 2146001 tetor
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	15/10/2020	16/10/2020	subvencion futbollit bashkia 2146001 shtator
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	23/09/2020	24/09/2020	subvencion futbollit bashkia 2146001 situacioni gusht
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,000,000	09/09/2020	10/09/2020	subvencion futbollit bashkia 2146001 korrik
Bashkia Selenice (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	60,000	13/08/2020	14/08/2020	2020 B SELENICE TE TJERA SHERBIME UP NR. 45, DT. 04.07.2020, FAT NR. 06, DT. 04.07.2020, SERIA 37619306
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,000,000	17/07/2020	20/07/2020	subvencion i futbollit bashkia 2146001 qershor
Bashkia Selenice (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	30,000	26/06/2020	29/06/2020	2020 B SELENICE TE TJERA SHERBIME, UP NR. 39, DT. 16.06.2020, FAT NR. 5, DT. 18.06.2020, SERIA 37619305, AKT MAREVESHJE NR. 1857, DT. 18.06.2020
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,000,000	24/06/2020	25/06/2020	subvencion i futbollit bashkia 2146001 maj
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	04/06/2020	05/06/2020	subvencion futbollit bashkia 2146001 prill
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	08/05/2020	11/05/2020	subvencion i pagave te futbollit bashkia 2146001 mars
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	09/03/2020	10/03/2020	subvencion futbollit bashkia 2146001 shkurt
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	600,000	11/02/2020	12/02/2020	subvencion futbollit bashkia 2146001 nentor
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	27/01/2020	28/01/2020	subvencion futbollit bashkia 2146001 janar
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,200,000	08/11/2019	11/11/2019	subvencion futbollit bashkia 2146001 tetor
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,200,000	10/10/2019	11/10/2019	subvencion futbollit bashkia 2146001 shtator
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,200,000	04/09/2019	06/09/2019	subvencion futbollit bashkia 2146001 gusht
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,200,000	08/08/2019	09/08/2019	subvencion futbollit bashkia 2146001 korrik
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	700,000	16/07/2019	17/07/2019	subvencion futbollit qershor bashkia 2146001
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,200,000	07/06/2019	10/06/2019	subvencion futbollit bashkia 2146001 maj
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,200,000	09/05/2019	10/05/2019	subvencion futbollit bashkia 2146001 prill
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,500,000	04/04/2019	05/04/2019	subvencion i futbollit bashkia 2146001 mars
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	1,000,000	15/03/2019	18/03/2019	subvencion futbollit bashkia 2146001 shkurti
Bashkia Vlore (3737)	K.F. ORIKU	Vlore	2,000,000	05/02/2019	06/02/2019	subvencion futbollit bashkia 2146001 janar

- Burimi i vjetërsisë së të ardhurave – tabela nr 3

Tabela nr 3

Vitet	Te ardhurat			Totali
	Grandet	Sponsorizim	Te ardhura te vetat	
2013	2,729,260	0	0	2,729,260
2014	6,000,000	0	0	6,000,000
2015	8,391,318	0	0	8,391,318
2016	8,000,000	25,000	90,292	8,115,292
2017	7,600,000	133,575	0	7,733,575
2018	11,900,000	810,000	0	12,710,000
2019	11,300,000	1,556,070	0	12,856,070
2020	13,600,000	1,246,487	75,000	14,921,487
2021	13,000,000	720,000	0	13,720,000
2022	0	8,517,400	0	8,517,400
2023	5,000,000	3,121,551	0	8,121,551
Totali	87,520,578	16,130,083	165,292	103,815,953

"Stadiumi i Orikumit"



- Pasqyrat e pozicionit financiar dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, , për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023;

Pasqyra e Pozicionit Financiar	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	1,023,734	856,954
Investime		
<i>Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>	0	0
<i>Te tjera financiare</i>	0	0
Te drejta te arketueshme		
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	0	0
<i>Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>	0	0
<i>Te tjera</i>	1,649,773	1,545,590
<i>Kapital i nenshkruar i papaguar</i>	3,000,000	3,000,000
Inventaret		
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	0	0
<i>Produkte te gatshme</i>	0	0
<i>Mallra</i>	0	0
<i>AAGJM te mbajtura per shitje</i>	0	0
<i>Parapagime per inventar</i>	0	0
Shpenzime te shtyra	0	0
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara	0	0
Totali i aktiveve afatshkurtra	5,673,507	5,402,544
Aktive afatgjate		
Aktive financiare		
<i>Tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>	0	0
<i>Tituj pronesie te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>	0	0
<i>Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjate</i>	0	0
<i>Tituj te tjere te huadhenies</i>	0	0
Aktive materiale		
<i>Toka dhe ndertesa</i>	88,908	93,588
<i>Impiante dhe makineri</i>	0	0
<i>Të tjera Instalime dhe pajisje invetar informatik</i>	0	0
<i>Të tjera Instalime dhe pajisje Inv.ekonomike</i>	0	0
<i>Parapagime per aktive materiale dhe ne proces</i>	0	0
Aktivitet biologjike	0	0
Aktive jo materiale		
<i>Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme</i>	0	0
<i>Emri i mire</i>	0	0
<i>Parapagime per AAJM</i>	0	0
Aktivitet tatimore te shtyra	0	0
Totali i aktiveve afatgjate	88,908	93,588
TOTALI I AKTIVEVE	5,762,415	5,496,132

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Detyrime afatshkurtra		
<i>Titujt e huamarrjes</i>	0	0
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>	0	0
<i>Aktetime ne avance per porosi</i>	0	0
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	1,051,132	845,972
<i>Deftesa te pagueshme (Divident)</i>	0	0
<i>Te pagueshme ndaj punonjeseve dhe sigurimeve shoq/shend</i>	270,746	278,680
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	0	0
<i>Te tjera te pagueshme</i>	1,006,062	1,006,062
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	0	0
Te ardhura te shtyra	0	0
Provizione	0	0
Totali i detyrimeve afatshkurtra	2,327,940	2,130,713
Detyrime afatgjata		
<i>Titujt e huamarrjes</i>	0	0
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>	0	0
<i>Aktetime ne avance per porosi</i>	0	0
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	0	0
<i>Deftesa te pagueshme</i>	0	0
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	0	0
Te ardhura te shtyra	0	0
Provizione		
<i>Provizione per pensione</i>	0	0
<i>Provizione te tjera</i>	0	0
Detyrime tatimore te shtyra	0	0
Totali i detyrimeve afatgjata	0	0
Detyrime totale	2,327,940	2,130,713
Kapitali dhe Rezervat		
Kapitali i nenshkruar	4,100,000	4,100,000
Primi i lidhur me kapitalin	0	0
Rezerva rivleresimi	0	0
Rezerva te tjera		
<i>Rezerva ligjore</i>	0	0
<i>Rezerva statutore</i>	0	0
Fitimi/(humbja) e pashperndare	-734,581	454,353
Fitimi/(humbja) e periudhes	69,057	-1,188,934
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	3,434,475	3,365,419
Interesa jo-kontrollues		
Totali i kapitalit	3,434,475	3,365,419
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	5,762,415	5,496,132

Pasqyra e Performances (sipas natyres)

	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit		
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	0	0
<i>Te ardhurat nga Grande</i>	5,000,000	0
<i>Te ardhurat nga sponsorizime</i>	3,121,551	8,517,400
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 3</i>	0	0
<i>Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	0	0
Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces	0	0
Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar	0	0
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	0	0
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	-942,204	-702,931
<i>Te tjera shpenzime</i>	0	0
Shpenzime te personelit		
<i>Paga dhe shperblime</i>	-3,152,134	-5,129,995
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	-526,581	-856,709
<i>Shpenzimet per pensionet</i>	0	0
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale	0	0
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	-4,680	-4,926
Shpenzime te tjera shfrytezimi	-3,416,200	-3,004,400
Te ardhura te tjera		
<i>Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*</i>	0	0
<i>Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>	0	0
<i>Te ardhura nga investimet dhe huate ne njesi brenda grupit, pjese e aktiveve afatgjata</i>	0	0
<i>Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike ku ka interesa pjesmarrese, pjese e aktiveve afatgjata</i>	0	0
<i>Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga njesi brenda grupit</i>	0	0
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra	0	0
Shpenzime financiare		
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme</i>	0	0
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu paguar tek njesite ekonomike brenda grupit *</i>	0	0
<i>Shpenzime te tjera financiare</i>	-10,695	-7,373
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet	0	0
Te tjera (Humbje nga kurset e kembimit)	0	0
Fitimi/(humbja) para tatimit	69,057	-1,188,934
Tatimi mbi fitimin		
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i>	0	0
<i>Tatim fitimi i shtyre</i>	0	0
<i>Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve</i>	0	0
Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)	69,057	-1,188,934

1.6 Verifikimi fizik i objekteve dhe paisjeve.

Në kuadër të punës sonë për përcaktimin e vlerës së drejtë të shoqërisë, ne kemi kërkuar zyrtarisht informacion Bashkisë Vlorë me shkresën tonë nr 20 datë 29.04.2024 e protokolluar me nr 6510 datë 29.04.2024 në protokollin e bashkisë dhe e përsëritur kërkesa me shkresën nr 23 datë 16.05.2024 e protokolluar me nr 6510/1 datë 17.05.2024 në protokollin e bashkisë. Në përgjigjen e kthyer nga Bashkia Vlorë me shkresën nr 9605/1 datë 26.06.2024 rezulton se nuk kemi informacion mbi pronësinë e aseteve që përdorë Shoqëria "KF Oriku"sha . Në këto kushte nga verifikimi fizik dhe dokumentar rezulton se Stadiumi i Orikut sëbashku me godinën e shërbimit dhe inventar ekonomik që përdor nuk janë pronë të shoqërisë por të Bashkisë Vlorë.

Vlera e drejtë e aktiveve afatgjata të cilat janë në përdorim të vazhdueshëm nga KF Oriku nuk janë pjesë e vlerësimit në këtë Raporti Vlerësimi për faktin se nuk janë pronë e shoqërisë (nuk ekziston një certifikatë pronësie apo kontratë përdorimi në emër të KF Oriku) . Inventari ekonomik i cili përbëhet nga 24 copë karrige kinemaje, 2 copë tavolina 1 njësi qendrore dhe 1 monitor referuar fletës së inventarit të datës 31 dhjetor 2023 janë pronë NJA Orikum.

Në pasqyrat financiare të shoqërisë vlera neto e mbetur në datën 31.12.2023 e Aktiveve Afatgjata Materiale rezulton në shumën 88,908 lekë e përfaqëson riparimin e *murit rrethues të terrenit sportiv*. Invenstim i kryer nga Bashkia Vlorë në shumën 123,000 lekë (*fatura tatimore nr serie 40808636 datë 28.08.2017 të lëshuar nga subjekti Athen Konstruktion shpk*)

1.7 Supozime dhe kufizime

Kjo detyrë është kryer me supozimet dhe kufizimet e mëposhtme të përgjithshme:

- Sipas njohurive tona më të mira, të gjitha të dhënat, duke përfshirë të dhënat financiare historike, nëse ka, të mbështetura në arritjen e opinioneve dhe konkluzioneve ose të parashtruara në këtë raport janë të vërteta dhe të sakta. Edhe pse të mbledhura nga burime që ne besojmë se janë të besueshme, nuk jepet asnjë garanci dhe as nuk merret përsipër përgjegjësi për vërtetësinë ose saktësinë e të dhënave, opinioneve ose vlerësimeve të dhëna nga të tjerët që janë përdorur në këtë analizë vlerësimi .
- Asnjë përgjegjësi nuk merret përsipër për çështje të natyrës ligjore. Asnjë hetim nuk është bërë për titullin ose ndonjë detyrim ndaj pronës së vlerësuar. Ne kemi supozuar se pretendimi i pronarit është i vlefshëm, të drejtat pronësore janë të mira dhe të tregtueshme dhe nuk ka barra që nuk mund të pastrohen përmes proceseve normale, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Raport.
- Vlerat e paraqitura në këtë raport bazohen në premisat e përshkruara këtu.

- Data e vlerësimit për të cilën zbatohen përfundimet dhe opinionet e shprehura përcaktohet në raport. Opinioni i vlerësimit i paraqitur aty bazohet në gjendjen e ekonomisë dhe në fuqinë blerëse të monedhës të deklaruar në raport në datën e vlerës.
- Duke marrë parasysh mjedisin e ndryshimit të vazhdueshëm të çmimeve që kanë ndikim në vlerësim, Raporti ynë është i kufizuar vetëm në ato çështje që na duket se kanë një ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e një vlere të përshtatshme për specifikën e pronës.
- Vlerësimi ynë bazohet në informacionin dhe të dhënat e ofruara nga shoqëria KF Oriku dhe Bashkia Vlorë. Ne jemi mbështetur në informacionin e marrë pa hetim shtesë ose konfirmim të pavarur për drejtësi dhe objektivitet të informacionit, dhe shumica e informacionit është mbledhur me kërkesën tonë.
- Fushëveprimi ynë i punës ka qenë i kufizuar për shkak të informacionit dhe të dhënave të pamjaftueshme të cilat nuk na janë prezantuar, dhe veçanërisht për sa vijon:
 - Plani i detajuar i zhvillimit të biznesit dhe shpjegimi i supozimeve për parashikimet financiare për periudhën nga janari 2024 e në vazhdim;
 - Raporte financiare dhe jofinanciare relevante që disponon shoqëria në vitet e fundit;
 - Listë të inventarit në përdorim ose në pronësi në proces hipotekimi oe jo;
 - Kontrata të lidhur më sportistët ose me subjekte sponsorizuese;
- Procedurat dhe kërkesat tona nuk përfshinin punë verifikuese ose nuk përbënin një auditim në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Prandaj, ne nuk shprehim asnjë opinion për asnjë të dhënë financiare apo informacion tjetër të përmendur në këtë raport.
- Ne rezervojmë të drejtën të rishikojmë të gjitha llogaritjet e përfshira ose të referuara në raportin tonë dhe, nëse e konsiderojmë të nevojshme, të rishikojmë opinionin tonë në dritën e çdo informacioni ekzistues në datën e vlerësimit që na bëhet i njohur pas datës së këtij Raportoni. Ne nuk kemi asnjë përgjegjësi për të përditësuar Raportin për ngjarjet dhe rrethanat që kanë ndodhur pas datës së këtij Raporti. Prandaj, ne nuk do të jemi përgjegjës për pasojat financiare ose të tjera që rrjedhin nga ndonjë gabim ose lëshim nga raporti ynë që rezulton nga kufizimet në fushëveprimi të përmendura në këtë raport dhe ju pranoni të na mbani të padëmshëm nga efektet e ndonjë gabimi të tillë ose mosveprim nëse nuk shkaktohet nga keqbesim nga ana jonë.
- Puna jonë ka qenë e kufizuar nga mungesa e të dhënave të tregut për çmimet e transaksioneve, kontratave të lidhura dhe të ngjashme për shkak të moszhvillimit të tregjeve dytësore për këtë lloj aktiviteti në vend.

1.8 Konfidencialiteti

Raporti është konfidencial dhe është përgatitur ekskluzivisht për menaxhmentin e Kompanisë dhe nuk duhet të përdoret, riprodhohet ose qarkullohet për ndonjë qëllim tjetër, tërësisht ose pjesërisht, pa pëlqimin tonë paraprak me shkrim. Një pëlqim i tillë do të jepet vetëm pas shqyrtimit të plotë të rrethanave në atë kohë.

1.9 Metodologjia

Ne kemi aplikuar *metodën e vlerës së drejtë për aktivet afatgjata materiale* duke u bazuar në të dhënat e paraqitur në pasqyrat financiare të shoqërisë KF Oriku sh.a më datë 31.12.2023. Për të aplikuar *metodën e vlerës së drejtë për aktivet afatgjata materiale*, ne jemi mbështetur në Pasqyrën e paaudituar të pozicionit financiar dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe të dhëna të tjera kontabël më 31 dhjetor 2023 dhe kemi bërë rregullime specifike aty ku e kemi parë të përshtatshme

Bazuar SKK-ve dhe SNRF 13 e cila parashikon se: Vlera e drejtë është një matje e bazuar në treg dhe nuk është një matje specifike e njësisë ekonomike. Për disa aktive dhe detyrime, mund që transaksione tregu të dukshme ose informata tregu të jenë të disponueshme. Për aktive dhe detyrime të tjera, nuk mund të jenë të disponueshme transaksione të dukshme tregu ose informata tregu. Megjithatë, objektivi i matjes me vlerën e drejtë në të dy rastet është i njëjtë-të vlerësojë çmimin me të cilin një *transaksion i zakonshëm* për të shitur aktivin ose për të transferuar detyrimin, do të kryhet në mes të *pjesëmarrësve të tregut* në datën e matjes, në kushtet aktuale të tregut (d.m.th. një *çmim daljeje* në datën e matjes nga këndvështrimi i një pjesëmarrësi tregu që zotëron aktivin ose ka detyrimin). Kur një çmim për një aktiv ose detyrim të njëjtë nuk është i evidentuar, njësia ekonomike mat vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi që maksimizon përdorimin e *inputeve përkatëse të verifikueshme* dhe minimizon përdorimin e *inputeve të paverifikueshme*. Meqë vlera e drejtë është një matje e bazuar në treg, ajo matet duke përdorur supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin për të caktuar çmimin e aktivit ose të detyrimit, duke përfshirë edhe supozimet mbi rrezikun. Si rezultat i kësaj, qëllimi i një njësie ekonomike për të mbajtur një aktiv ose për të shlyer apo, ndryshe, për të përmbushur një detyrim, nuk është i rëndësishëm në matjen e vlerës së drejtë.

Ne kemi aplikuar *metodën e vlerësimit i emrit të mirë, ose "goodwill,"* të një klubi futbollit përfshin vlerësimin e aseteve jo të prekshme që lidhen me reputacionin, markën, dhe bazën e tifozëve të klubit. Ky komponent është shpesh një pjesë thelbësore e vlerës së përgjithshme të një klubi, veçanërisht në industrinë e sportit, ku besnikëria e tifozëve dhe ndikimi kulturor luajnë një rol të madh

Ne kemi aplikuar *metodën e kapitalit neto* e cila është një metodë që përdoret për të vlerësuar një biznes duke analizuar kapitalin e tij neto. Kapitali neto përfaqëson diferencën midis aktiveve totale dhe detyrimeve totale të një kompanie, duke ofruar një tregues të vlerës së pastër të aseteve të saj. Kjo metodë mund të përdoret në disa kontekste, si për të vlerësuar vlerën e një kompanie për qëllime shitjeje ose blerjeje, për të vlerësuar aftësinë e saj për të përballuar borxhet, ose për të analizuar shëndetin financiar të saj

Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC - Weighted Average Cost of Capital) është një masë që reflekton koston mesatare që një kompani paguan për kapitalin e saj, duke përfshirë si kapitalin e huazuar (borxhin) ashtu edhe kapitalin e pronarëve (kapitalin e aksionerëve). WACC përdoret shpesh në vendimmarrjen e investimeve dhe në vlerësimin e ndërmarrjeve.

Modeli i Çmimit të Aseteve Kapitale (CAPM) është një model financiar i përdorur për të përcaktuar kthimin e pritur të një investimi bazuar në rrezikun e tij sistematik në lidhje me tregun e përgjithshëm. CAPM i ndihmon investitorët të kuptojnë marrëdhënien midis rrezikut dhe kthimit të pritur dhe përdoret gjerësisht në financa për çmimin e aktiveve dhe menaxhimin e portofolit.

Treguesit e Aktivit të pasqyrat në pasqyrat financiare të shoqërisë nga viti 2013 -2023 paraqitet si më poshtë: - tabela nr 4

Tabela nr.4

Pasqyra e Bilancit të shoqërisë	Treguesit e Aktivit dhe Pasivit sipas viteve												
	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023		
AKTIVET													
Aktive monetare	146,117	190,545	117,829	605,215	396,778	750,036	448,331	600,242	1,988,571	856,954	1,023,734		
<i>Aktive të tjera financiare qfatishtkaura</i>													
Klienta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Detyrime tatimore	0	0	0	129,515	482,290	808,995	1,174,079	1,533,696	1,533,696	1,545,590	1,649,773		
Te drejtat ndaj ortakëve	4,100,000	4,100,000	4,100,000	4,100,000	4,100,000	4,100,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000		
<i>Aktive qfatishtka materiale</i>													
Toka	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ndertesa	0	0	0	0	120,950	114,902	109,157	103,699	98,514	93,588	88,908		
Makinieri paisje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Inventar ekonomik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	4,246,117	4,290,545	4,217,829	4,834,730	5,100,018	5,773,933	4,731,567	5,237,637	6,620,781	5,496,132	5,762,415		
DETYRIMET													
Te pagueshme ndaj furnitoreve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	845,972	1,051,132		
Te pagueshme ndaj punonjësve	0	44,832	74,307	0	127,005	132,063	363,978	752,627	768,696	0	0		
Te pagueshme ndaj ortakëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
Detyrime tatimore	73,377	59,036	32,694	72,624	45,710	126,959	111,969	195,191	291,360	278,680	270,746		
Grande dhe te ardhura te shtyra	72,740	72,740	0	0	0	0	0	506,372	1,006,372	1,006,062	1,006,062		
Kapitali i aksioner	4,100,000	4,100,000	4,100,000	4,100,000	4,100,000	4,100,000	4,100,000	4,100,000	4,100,000	4,100,000	4,100,000		
Rezervat ligjore dhe statutore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
Fitime te pashperndare	0	0	13,937	10,828	662,106	827,303	1,414,911	155,620	-316,553	454,352	-734,582		
Fitime(humbje) ushtrimore	0	13,937	-3,109	651,278	165,197	587,608	-1,259,291	-472,173	770,906	-1,188,934	69,057		
Totali	4,246,117	4,290,545	4,217,829	4,834,730	5,100,018	5,773,933	4,731,567	5,237,637	6,620,781	5,496,132	5,762,415		
dif	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

2- Përmbledhja Vlerësimit

Shoqëria audituese KEI-AL Auditing ka përgatitur këtë Raport Vlerësimi në përputhje me procedurat dhe me qëllimin e punës të rënë dakord në kontratën tonë nr 5905 të datës 18.04.2024 dhe Standardet Ndërkombëtare të Vlerësimit 2023. Bazuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Vlorë është kërkuar të ofrojë një analizë vlerësimi, për të përcaktuar vlerën e aseteve të shoqërisë më 31 dhjetor 2023. Qëllimi i vetëm i analizës së vlerësimit ishte vlerësimi i aseteve të Klubeve të Futbollit "Flamurtari Futboll Club" dhe "K.F. Oriku" për privatizim dhe asnjë qëllim tjetër nuk synohet dhe nuk duhet të konkludohet.

Objektivi i vlerësimit është të shprehë një opinion të pavarur mbi vlerën e drejtë të Shoqërisë, mbi bazën e vazhdimësisë, më 31 dhjetor 2023.

Vlera e drejtë SNRF 13 përkufizohet njësoj si vlera e tregut, dmth si "shuma e vlerësuar për të cilën një aktiv ose pasiv duhet të këmbëhet në datën e vlerësimit midis një blerësi të gatshëm dhe një shitësi të gatshëm në një transaksion të barabartë pas marketingut të duhur dhe kur palët kishin vepruar secila me dijeni, me maturi dhe pa detyrim".

Një aplikim i zakonshëm i *vlerës së drejtë* është për vlerësimin e çmimit që është i drejtë për aksionet në një biznes, ku sinergjitë e veçanta midis dy palëve specifike mund të nënkuptojnë se çmimi që është i drejtë midis tyre është i ndryshëm nga çmimi që mund të merret në gjerësi tregu.

Përfundimi i vlerës së drejtë të arritur është një vlerësim i arsyeshëm i çmimit me të cilin prona mund të ndryshojë duart ndërmjet dy palëve të gatshme. Duhet të kuptohet se çmimi aktual i paguar në një transaksion që përfshin këtë pronë mund të ndryshojë nga vlera e vlerësuar për shkak të faktorëve të tillë si motivimi i palëve, aftësitë negociuese të palëve, struktura e transaksionit (p.sh. struktura e financimit), kostot ose përfitimet që mund të mos reflektohen në rezultatet e paraqitura më poshtë ose në faktorë të tjerë unikë për transaksionin.

Vlerësimi ynë i shoqërisë përfaqëson perceptimin tonë duke marrë parasysh vlerën reale të shoqërisë. Ai nuk përfaqëson vlerën e shoqërisë siç mund të merret nga investitorët ose nëpërmjet shitjes ose transferimit të shoqërisë në një shoqëri tjetër.

Rezultatet nuk duhet të interpretohen si shuma që një blerës i mundshëm duhet ose do të paguajë përfundimisht. Çmimi përfundimtar do të pasqyrojë fuqinë relative të negociatave dhe termat dhe kushtet e negociuara ndërmjet palëve përkatëse, kostot ose përfitimet të cilat mund të mos reflektohen në rezultatet e paraqitura më poshtë.

Vlerësimi i shoqërisë është kryer në bazë të parimit të vazhdimësisë, dmth. nën supozimin se menaxhmenti i shoqërisë do të kryejë vetëm ato strategji financiare dhe operacionale që do t'i mundësojnë shoqërisë të operojë dhe të zhvillohet në të ardhmen.

Vlerësimi i kompanisë është kryer në përputhje me metodologjitë e vlerësimit të njohura ndërkombëtarisht. Për qëllime të vlerësimit të Kompanisë, ekipi ynë i pavarur i vlerësuesve përdori metodologji të ndryshme vlerësimi. Ne e kemi kryer vlerësimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Vlerësimit të nxjerra nga Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve të Vlerësimit

Vlerësimi i Kompanisë është kryer duke aplikuar metodologjinë e vlerësimit të aseteve neto dhe fluksit të parasë së skontuar . Bazuar në analizën e bërë, metoda e skontuar e fluksit monetar konsiderohet si më e përshtatshme për vlerësimin e kompanisë në vazhdimësi. Qasja e aseteve neto për vlerën e kompanisë është paraqitur vetëm për qëllime informative.

Rezultatet e vlerësimit të Shoqërisë “K.F.Oriku” Sh.A është si më poshtë:

Vlera e Shoqërisë K F ORIKU sh.a	12,658,000 lekë
----------------------------------	-----------------

Vlerësimi ynë bazohet në informacionin dhe të dhënat e ofruara nga Bashkia Vlorë dhe të dhënat e publikuar nga ana e shoqërisë në regjistrin tregtar të biznesit (QKB). Ne u mbështetëm në informacionin e marrë pa hetim shtesë ose konfirmim të pavarur për drejtësi dhe objektivitet të informacionit, dhe shumica e informacionit u mblodh me kërkesën tonë. Një pjesë e dokumentacionit teknik për vlerësimin nuk na është ofruar nga Drejtimi i shoqërisë për arsye të justifikuara.

Procedurat dhe kërkesat tona nuk përfshinin punë verifikuese ose nuk përbënin një auditim në përputhje me standardet e pranuar përgjithësisht të kontabilitetit. Prandaj, ne nuk shprehim asnjë opinion për asnjë të dhënë financiare apo informacion tjetër të përmendur në këtë raport.

3- Analiza, vlerësimi dhe rregullimet në pasqyrat financiare që mundësojnë vlerësimin e shoqërisë dhe rrisin interesin e blerësve të mundshëm

Procesi i zgjedhjes së metodave të vlerësimit të aplikueshme për vlerësimin e klubeve të futbollit është paraprirë nga një studim i përvojave të tjera në këtë fushë dhe i të dhënave financiare dhe jofinanciare të disponueshme nga klubit. Zbatimi i metodave të vlerësimit bëjnë të mundur që procesi i vlerësimit të K F Oriku të jetë i drejtë dhe të harmonizojë sa më mirë interesat e sotme dhe të ardhme të Bashkisë Vlore dhe komunitetit të qytetit të Orikut.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë KF Oriku sh.a është bërë vlerësimi dhe saktësimi i gjendjes pasurore të shoqërisë më datë 31.12.2023. Bazuar SKK-ve dhe SNRF 13 e cila parashikon se: Vlera e drejtë është një matje e bazuar në treg dhe nuk është një matje specifike e njësisë ekonomike. Për disa aktive dhe detyrime, mund që transaksione tregu të dukshme ose informata tregu të jenë të disponueshme. Për aktive dhe detyrime të tjera, nuk mund të jenë të disponueshme transaksione të dukshme tregu ose informata tregu. Megjithatë, objektivi i matjes me vlerën e drejtë në të dy rastet është i njëjtë-të vlerësojë çmimin me të cilin një *transaksion i zakonshëm* për të shitur aktivin ose për të transferuar detyrimin, do të kryhet në mes të *pjesëmarrësve të tregut* në datën e matjes, në kushtet aktuale të tregut (d.m.th. një *çmim daljeje* në datën e matjes nga këndvështrimi i një pjesëmarrësi tregu që zotëron aktivin ose ka detyrimin).

Kur një çmim për një aktiv ose detyrim të njëjtë nuk është i evidentuar, njësia ekonomike mat vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi që maksimizon përdorimin e *inputeve përkatëse të verifikueshme* dhe minimizon përdorimin e *inputeve të paverifikueshme*. Meqë vlera e drejtë është një matje e bazuar në treg, ajo matet duke përdorur supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin për të caktuar çmimin e aktivit ose të detyrimit, duke përfshirë edhe supozimet mbi rrezikun. Si rezultat i kësaj, qëllimi i një njësie ekonomike për të mbajtur një aktiv ose për të shlyer apo, ndryshe, për të përmbushur një detyrim, nuk është i rëndësishëm në matjen e vlerës së drejtë.

Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose çmimi që do të paguhej për të transferuar një detyrim, në një transaksion të zakonshëm, në tregun kryesor (ose më të favorshëm), në datën e matjes, në kushtet aktuale të tregut (d.m.th. një çmim daljeje), pavarësisht nëse ky çmim është i evidentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose i vlerësuar duke përdorur një teknikë vlerësimi.

Rezultatet e punës së vlerësimit, të përmbledhura më poshtë, ofrojnë një tregues se çfarë mund të jetë i përgatitur të paguajë një blerës i mundshëm për shoqërinë me synimin për të vazhduar biznesin ekzistues. Rezultatet nuk duhet të interpretohen si shuma që një blerës i mundshëm duhet ose do të paguajë përfundimisht. Vlera e vlerësuar nuk përfaqëson shumën që do të ishte e mundur të merret nga investitorët ose nëpërmjet shitjeve ose transferimit në një shoqëri tjetër.

Më poshtë janë paraqitur të gjitha rregullimet dhe vlerësimet paraprake, dhe më pas mbi bazën e tyre janë përgatitur bilanci kontabël dhe pasqyrat e tjera financiare të vlerësimit të gjendjes pasurore të shoqërisë

3.1 Vlerësimi i aktiveve afatgjata

Vlerësimi i aktiveve afatgjata në një shoqërie është një proces që përfshin analizimin e vlerës dhe gjendjes së pasurive që pritet të përdoren për periudha më të gjata se një vit. Këto aktive përfshijnë ndërtesat, makineritë, pajisjet, patentat, markat tregtare dhe pasuritë e patundshme. Ky proces është thelbësor për raportimin financiar, vendimmarrjen strategjike dhe vlerësimin e performancës së kompanisë.

Ja disa hapa kryesorë në vlerësimin e aktiveve afatgjata:

- **Identifikimi i aktiveve:** Përcaktimi i saktë i çfarë përbën një aktiv afatgjatë në kontekstin e kompanisë.
- **Vlerësimi fillestar :** Vendosja e vlerës fillestare të aktiveve bazuar në koston e blerjes ose koston e ndërtimit, përfshirë kostot e tjera të lidhura, si instalimi dhe testimi.
- **Amortizimi :** Llogaritja e amortizimit për të shpërndarë koston e një aktivi mbi jetën e tij të dobishme. Ky proces ndihmon në reflektimin e vlerës së zvogëluar të aktivëve në kohë.
- **Vlerësimi i dëmtimit :** Përcaktimi nëse një aktiv ka pësuar dëmtime që kanë ndikuar në vlerën e tij dhe llogaritja e vlerës së tij aktuale në treg.
- **Riklasifikimi dhe shitja :** Riklasifikimi i aktiveve të cilat nuk përdoren më për qëllimet e tyre fillestare ose janë për t'u shitur, si dhe regjistrimi i fitimeve ose humbjeve nga shitja e tyre.
- **Raportimi financiar:** Prezantimi i vlerës së aktiveve afatgjata në bilanc dhe raportet e tjera financiare të kompanisë.
-

Për të realizuar këto hapa, është e rëndësishme të përdoren standardet e pranuar ndërkombëtare të kontabilitetit, si IFRS (Standardet Ndërkombëtare të Raportimit

Financiar) ose GAAP (Parimet e Pranuara Përgjithësisht të Kontabilitetit), në varësi të juridiksionit dhe kërkesave të raportimit të kompanisë.

Vlerësimi i aktiveve afatgjata bazohet në disa parime të pranuar përgjithësisht, të cilat sigurojnë që vlerësimi të jetë i saktë, i qëndrueshëm dhe i krahasueshëm. Këto parime janë përcaktuar nga standarde të tilla si Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) dhe Parimet e Pranuara Përgjithësisht të Kontabilitetit (GAAP). Ja disa nga parimet kryesore:

- Parimi i Kostos Historike : Pasuritë regjistrohen fillimisht në librat e kompanisë sipas kostos historike, që është çmimi i blerjes ose kostoja e prodhimit të tyre. Kjo vlerë përfshin të gjitha kostot e nevojshme për të sjellë aktivin në gjendjen e tij funksionale, si transporti, instalimi dhe testimi.
- Parimi i Amortizimit: Amortizimi është një proces i shpërndarjes së kostos së një aktivi afatgjatë mbi jetën e tij të dobishme. Kjo reflekton përdorimin dhe konsumimin e aktivës gjatë kohës dhe ndihmon në përputhjen e kostos së aktivës me të ardhurat që gjeneron.
- Parimi i Dëmtimit : Pasuritë duhet të rishikohen për dëmtim nëse ka indikacione se vlera e tyre e realizueshme është zvogëluar në krahasim me vlerën kontabile. Nëse vlera e tregut ose e përdorimit të një aktivi është më e ulët se vlera e tij kontabile, një humbje nga dëmtimi duhet të regjistrohet.
- Parimi i Jetës së Dobishme: Përcaktimi i jetës së dobishme të një aktivi është thelbësor për llogaritjen e amortizimit. Jeta e dobishme mund të përcaktohet nga faktorë të tillë si përdorimi i pritur, vjetërsimi teknologjik, dhe faktorët ekonomikë.
- Parimi i Konsistencës: Metodatat e vlerësimit dhe amortizimit të përdorura duhet të jenë konsistente nga viti në vit për të siguruar krahasueshmëri në raportet financiare. Çdo ndryshim në metodologji duhet të shpjegohet dhe të bëhet i ditur në shënimet e llogarive financiare.
- Parimi i Zbulimit: Të gjitha detajet përkatëse mbi metodatat e vlerësimit, përfshirë amortizimin dhe humbjet nga dëmtimi, duhet të zbulohen në shënimet financiare për të siguruar transparencë dhe informim të plotë për përdoruesit e raporteve financiare.

Metoda e vlerës neto të aktiveve afatgjata materiale, e njohur edhe si "vlera e kontabilizuar neto" ose "vlera neto e librit kontabë" është një qasje për të përcaktuar vlerën aktuale të një aktivi të tillë në bilancin e kompanisë. Ky vlerësim bazohet në koston origjinale të aktivës, minus çdo amortizim të akumuluar dhe humbje nga dëmtimi.

Në kuadër të punës sonë për përcaktimin e vlerës së drejtë të shoqërisë, ne kemi kërkuar zyrtarisht informacion Bashkisë Vlorë me shkresën tonë nr 20 datë 29.04.2024 e protokolluar me nr 6510 datë 29.04.2024 në protokollin e bashkisë dhe e përsëritur kërkesa me shkresën nr 23 datë 16.05.2024 e protokolluar me nr 6510/1 datë

17.05.2024 në protokollin e bashkisë. Në përgjigjen e kthyer nga Bashkia Vlorë me shkresën nr 9605/1 datë 26.06.2024 rezulton se nuk kemi informacion mbi pronësinë e aseteve që përdorë Shoqëria "KF Oriku"sha . Në këto kushte nga verifikimi fizik dhe dokumentar rezulton se Stadiumi i Orikutit sëbashku me godinën e shërbimit dhe inventar ekonomik që përdor nuk janë pronë të shoqërisë por të Bashkisë Vlorë.

Vlera e drejtë e aktiveve afatgjata në përdorim të vazhdueshëm nuk janë pjesë e vlerësimit në këtë Raporti Vlerësimi për faktin se nuk janë pronë e shoqërisë (nuk ekziston një certifikatë pronësie apo kontratë përdorimi në emër të KF Oriku) . Inventari ekonomik i cili përbëhet nga 24 copë karrige kinemaje, 2 copë tavolina 1 njësi qendrore dhe 1 monitor referuar fletës së inventarit të datës 31 dhjetor 2023 janë pronë NJA Orikum.

Në pasqyrat financiare të shoqërisë vlera neto e mbetur në datën 31.12.2023 e Aktiveve Afatgjata Materiale rezulton në shumën 88,908 lekë e përfaqëson riparimin e murit rrethues të terrenit sportiv. Invenstim i kryer nga Bashkia Vlorë në shumën 123,000 lekë (fatura tatimore nr serie 40808636 datë 28.08.2017 të lëshuar nga subjekti Athen Konstruktion shpk). Asetet afatgjata të shoqërisë të pasqyruar në pasqyrat financiare më datën 31.12.2023 paraqiten si më poshtë: - tabela nr 8

Tabela nr 8

Më 31 Dhjetor 2023	Vlera neto kontabël	Rregullimi i vlerës	Vlera e drejtë
Toka dhe ndertesa	0	0	0
Riparim muri rrethues	88,908	0	88,908
Implante dhe makineri	0	0	0
Të tjera Instalime dhe pajisje inventar informatik	0	0	0
Mjetet afatgjata materiale	88,908	0	88,908

Vlera neto e dobishme e financuar nga Bashkia Vlore do të përfshihet në vlerën e vlerësuar të shoqërisë si obligim për ti kthyer si detyrim ndaj Bashkisë në shumën **88,908 lekë** e cila është edhe pronare e ligjshme për këtë investim të kryer.

3.2 Vlerësimi i aktiveve afatgjata jo materiale (Emri i mirë)

Në vlerësimin e një klubi futbollit është e rëndësishme që në analizën e vlerësimit duhet të merret në konsiderat edhe vlerësimi i aktiveve jo materile të cilat në të shumtën e rasteve nuk janë të llogaritur apo paraqitur si të tilla në gjendjen e pasqyrave financiare të shoqërisë . Në vlerësim duhet të marrim parasysh disa element që përdoren në disa metoda dhe faktorë të veçantë që mund të ndihmojnë në këtë proces. Disa prej metodave

dhe faktorëve për t'u konsideruar janë: *Vlerësimi i emrit të mirë ose "goodwill" ; Metoda "Forbes" dhe vlerësimi i lojtarëve.*

a) Vlerësimi i emrit të mirë ose "Goodwill"

Vlerësimi i emrit të mirë, ose "goodwill," të një klubi futbollit përfshin vlerësimin e aseteve jo të prekshme që lidhen me reputacionin, markën, dhe bazën e tifozëve të klubit. Ky komponent është shpesh një pjesë thelbësore e vlerës së përgjithshme të një klubi, veçanërisht në industrinë e sportit, ku besnikëria e tifozëve dhe ndikimi kulturor luajnë një rol të madh. Metodatat dhe faktorët kryesorë për llogaritjen e emrit të mirë përfshijnë:

- *Vlera e Markës* : Kjo përfshin njohjen e markës, reputacionin dhe besnikërinë e tifozëve. Këta faktorë ndihmojnë në rritjen e të ardhurave nga biletat, shitjet e produkteve të lidhura, dhe marrëveshjet e sponsorizimit.
- *Të Drejtat e Transmetimit*: Kontratat e televizioneve dhe transmetimit janë një burim i madh të ardhurash për klubet e futbollit dhe reflektojnë interesin dhe popullaritetin e klubit.
- *Marrëveshjet e Sponsorizimit* : Të ardhurat nga sponsorizimet janë një tregues i drejtpërdrejtë i vlerës së markës së klubit dhe tërheqjes së tij në treg.
- *Karta e Tifozëve* : Numri dhe përkushtimi i tifozëve, përfshirë praninë në stadium dhe ndjekësit në mediat sociale, janë tregues të vlerës së emrit të mirë të një klubi.
- *Histori dhe Trashëgimi*: Sukseset historike të klubit, përfshirë trofetë dhe pjesëmarrjet në kompeticione të mëdha, kontribuojnë në emrin e mirë dhe markën e klubit.
- *Përgjithësimi i të Ardhurave*: Llogaritja e vlerës së emrit të mirë mund të bëhet duke përlllogaritur fitimet mesatare të klubit dhe pastaj duke i kapitalizuar ato me një normë diskontimi që reflekton rrezikun dhe pasigurinë në lidhje me këto të ardhura të ardhshme.
- *Krahasimi i Shitjeve të Klubeve të Ngjashme*: Analiza e transaksioneve të mëparshme të klubeve të ngjashme mund të japë një ide për vlerën e tregut të një klubi dhe për emrin e tij të mirë.
- *Analiza e Shumëfishëve*: Përdorimi i shumëfishëve të vlerësimit, të tilla si (vlera e ndërmarrjes ndaj të ardhurave), mund të ndihmojë në vlerësimin e emrit të mirë, veçanërisht kur krahasohen klubet me njëri-tjetrin.

“Goodwill” shpesh është një vlerë e mbetur pas vlerësimit të aseteve të prekshme dhe detyrimeve të klubit dhe përfaqëson aspektet e markës dhe reputacionit që nuk mund të maten lehtësisht me parametra të tjerë financiarë.

b) Metoda “Forbes”

Metoda “Forbes” për vlerësimin e klubeve sportive, duke përfshirë edhe klubet e futbollit, është një qasje e njohur që përdoret nga revista Forbes për të renditur dhe vlerësuar vlerën e klubeve në nivel global. Kjo metodë kombinon një sërë faktorësh për të dhënë një vlerësim të përgjithshëm të vlerës së një klubi. Metoda Forbes përdor këto të dhëna për të përcaktuar vlerën totale të një klubi, duke marrë parasysh edhe faktorët e rrezikut dhe normat e kthimit në investim. Kjo metodë është e bazuar në të dhëna publike dhe private dhe përpjekjet e Forbes për të krijuar një panoramë të saktë të vlerës financiare të klubeve. Metoda Forbes është konsideruar një standard në industri për vlerësimin e klubeve sportive dhe përdoret gjerësisht nga investitorët, analistët financiarë dhe mediat për të kuptuar dhe krahasuar vlerën e klubeve të ndryshme. Disa nga komponentët kryesorë që Forbes përdor në këtë metodë janë:

- *Të Ardhurat e Gjeneruara:* Forbes vlerëson të ardhurat totale të klubit nga burime të ndryshme si biletat, të drejtat e transmetimit, sponsorizimet, shitjet e produkteve të markuara dhe të ardhurat nga ditët e ndeshjeve.
- *Të Drejtat e Transmetimit:* Të ardhurat nga kontratat për të drejtat e transmetimit televiziv dhe dixhital janë një komponent kyç, pasi ato pasqyrojnë interesin dhe popullaritetin e klubit.
- *Vlera e Stadiumit:* Vlera e stadiumit, përfshirë të ardhurat nga përdorimi i tij për qëllime të ndryshme si ndeshje, koncerte dhe ngjarje të tjera, është një faktor i rëndësishëm.
- *Asetet dhe Detyrimet:* Këtu përfshihen vlerësimi i aseteve fizike (p.sh. stadiumet, terrenet e trajnimit) dhe detyrimet financiare (p.sh. borxhet e klubit).
- *Vlera e Markës :* Një komponent i rëndësishëm që përfshin reputacionin, njohjen e markës dhe bazën e tifozëve të klubit.
- *Shitjet e Produkteve dhe Shërbimeve të Lidhura me Markën:* Kjo përfshin të ardhurat nga shitjet e produkteve të markuara, si fanellat dhe aksesoret e tjerë, si dhe shërbimet e ofruara nga klubi.

- *Rezultatet Sportive dhe Sukseset Historike:* Performanca në kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare mund të ndikojë në vlerësimin e klubit, për shkak të ndikimit të saj në të ardhurat dhe vlerën e markës.

c) Vleresimi i lojtarëve!


Vlerësimi i lojtarëve në një klub futbollit është një proces kompleks që merr parasysh shumë faktorë, të cilët ndikojnë në vlerën e përgjithshme të një lojtari. Disa nga metodat dhe kriteret kryesore për vlerësimin e lojtarëve janë:

- *Performanca Sportive:* Statistikat për Golat, asistet, ndeshjet e luajtura, mbrojtjet, dhe statistika të tjera relevante.
- *Konsistenca :* Niveli i performancës gjatë një periudhe të gjatë kohore.- Roli dhe Pozicioni, - Vlera e lojtarit mund të ndryshojë varësisht nga pozicioni i tij dhe rëndësia e rolit që luan në ekip.
- *Mosha dhe Potenciali :-* Mosha : Lojtarët më të rinj shpesh kanë një vlerë më të lartë për shkak të potencialit të zhvillimit dhe karrierës së gjatë para tyre. - Potenciali për Zhvillim . Vlerësimi i potencialit për përmirësim të mëtejshëm.- Gjendja Fizike dhe Shëndeti . Vlerësimi i shpejtësisë, forcës, qëndrueshmërisë, dhe aftësive të tjera fizike.
- *Reputacioni dhe Popullariteti:* - Fama dhe Popullariteti: Lojtarët e njohur dhe të famshëm shpesh kanë një vlerë më të lartë për shkak të ndikimit të tyre jashtë fushës, përfshirë marketingun dhe të ardhurat nga sponsorizimet.- Roli si Model: Ndikimi i tyre pozitiv në ekip dhe komunitet.
- *Kontrata dhe Faktorët Financiarë :* Kohëzgjatja e Kontratës: Lojtarët me kontrata të gjata dhe pa klauzola të ulëta të lirimimit zakonisht kanë një vlerë më të lartë. Pagat dhe Kompensimi: Lojtarët me paga më të larta mund të kenë një vlerë më të ulët në treg për shkak të kostos së tyre për klubet blerëse.
- *Tregu dhe Konkurrenca:* Vlera e një lojtari mund të rritet nëse ka shumë klube të interesuara. Krahasimi me Lojtarët e Ngjashëm për të përcaktuar një vlerë tregu. Aftësitë dhe Atributet Teknike: Përfshirë driblimin, pasimin, shënimin e golave, dhe aftësitë mbrojtëse. Inteligjenca Taktike: Aftësia për të kuptuar dhe zbatuar strategjitë e lojës.

Shoqëria KF Oriku sha e ushtron aktivitetin në Stadiumin Orikum pronë të Bashkisë Vlorë bazuar në të dhënat e nxerr nga faqja zyrtare e Federatës Shqiptare e Futbollit (FSHF) rezulton se Klubi KF Oriku ka zhvilluar ndeshje si më poshtë :

13:48

Garat - FSHF
fshf.org



Shteti: AL
Region: VLORE
Town: ORIKUM
Kodi postar:
Status: ACTIVE
Organisation Nature: CLUB

REZULTATET E NDESHJEVE

Zgjidh sezonin
2024

Zgjidh kampionatin
Turi i Dytë 1/32


EKUPI VENDAS	REZULTATI	EKUPI MIK
Oriku	2 - 0	Pogradeci

13:47

EKUPI VENDAS	REZULTATI	EKUPI MIK
Oriku	1 - 2	Kelcyra
Turbina	4 - 3	Oriku
Oriku	2 - 3	AF Luftëtari
Devolli	2 - 1	Oriku
Oriku	4 - 0	Delvina
Labëria	1 - 0	Oriku
Oriku	2 - 1	Butrinti
Pogradeci	1 - 0	Oriku
Oriku	1 - 0	Maliqi
Shkumbini	1 - 0	Oriku
Kelcyra	0 - 2	Oriku
Oriku	4 - 0	Turbina
AF Luftëtari	1 - 0	Oriku
Oriku	1 - 0	Devolli
Delvina	0 - 0	Oriku
Oriku	1 - 1	Labëria
Butrinti	1 - 1	Oriku
Oriku	1 - 1	Pogradeci
Maliqi	1 - 2	Oriku
Oriku	1 - 0	Shkumbini

13:47

Garat - FSHF
fshf.org



Shteti: AL
Region: VLORE
Town: ORIKUM
Kodi postar:
Status: ACTIVE
Organisation Nature: CLUB

REZULTATET E NDESHJEVE

Zgjidh sezonin
2024

Zgjidh kampionatin
Turi i Tretë 1/16

EKUPI VENDAS	REZULTATI	EKUPI MIK
Dinamo City	2 - 0	Oriku

Burimi: Federata Shqiptare e Futbollit

Renditja

NR.	SKUADRA	P	NL	F	B	M	GSH	GP	DG	PP
1	Pogradeci	52	20	16	4	0	40	11	29	0
2	AF Luftëtari	48	20	15	3	2	37	16	21	0
3	Shkumbini	42	20	13	3	4	30	16	14	0
4	Oriku	28	20	8	4	8	27	20	7	0
5	Butrinti	27	20	8	3	9	28	24	4	0
6	Labëria	27	20	8	3	9	25	28	-3	0
7	Devolli	24	20	7	3	10	33	38	-5	0
8	Turbina	23	20	7	2	11	27	36	-9	0
9	Delvina	20	20	5	5	10	26	34	-8	0
10	Maliqi	14	20	4	2	14	23	37	-14	0
11	Kelcyra	9	20	3	0	17	9	45	-36	0

Burimi: Federata Shqiptare e Futbollit

Shoqëria KF Oriku sha e ushtron aktivitetin në Stadiumin Orikum pronë të Bashkisë Vlorë e cila nga informacionin e marr nga vet klubi stadiumi ka rreth 600 vende dhe frekentohet nga rreth 200 tifozë për cdo ndeshje të zhvilluar . Shoqëria ka përfituar të ardhura nga biletat vetën në vitin 2016 në masën 90,292 lekë dhe në vitin 2020 në masën 75,000 lekë. Të ardhurat nga sponsorizimet nga viti 2016 deri në vitin 2023 shoqëria ka përfituar 16,130,083 lekë (tabela nr 3 e Raportit) plus shuma e sponozimeve të papërdorur e pasqyruar në pasiv të pasqyrave financiare të vitit 2023 në masën 1,006,062 lekë , mestarisht të ardhurat nga sponsorizimet janë në shumën 2,142,018 lekë Në terreni sportiv ekzistoj rreth 7 vende reklame. Për vitin 2023-2024 Klubi ka zhvilluar 22 ndeshje futbollit brenda dhe jashtë fushës së vet. Të ardhurat që mund të sigurohen nga shitja e biletave dhe reklamave për një edicion sportiv po i paraqesim në tabelën si më poshtë : - tabela nr 9

Tabela nr 9

Vlerësimi i Emrit të Mirë	Vlera neto kontabël	Rregullimi i vlerës	Vlera e drejtë	Shënime
Vlera e Markes se Klubit	0	0	0	Markë e pa regjistruar
Shitjet e produkteve dhe shërbimeve të lidhura me Markën	0	0	0	Nuk ka produkte te kesaj marke
Të ardhura nga e drejta e transmetimit	0	0	0	Nuk ka informacion per perfitimin
Të ardhurat mesatare nga marrëveshjet e sponsorizimit	0	2,142,018	2,142,018	Te ardhurat mesatare nga sponozizimet
Të ardhurat nga biletat sportive	0	550,000	550,000	200 persona *250 leke*11 ndeshje
Të ardhurat nga reklama	0	350,000	350,000	VKB nr 96 dt 07.12.2023
Historia dhe trashëgimia e klubit	0	0	0	Nuk ka te dhena zyrtare as enciklopedike
Rezultat sportive dhe sukses historike	0	0	0	Nuk ka fituar trofe apo tituj sportiv
Të ardhura nga karta e tifozit	0	0	0	Nuk nje te tille nga shoqeria
<i>Vlerësimi i lojtareve</i>	0	0	0	
Performanca Sportive	0	0	0	Nuk informacin dhe analize te detajuar
Konsistenca	0	0	0	Nuk informacin dhe analize te detajuar
Reputacioni dhe Popullariteti	0	0	0	Nuk informacin dhe analize te detajuar
Kontrata dhe Faktorët Financiarë	0	0	0	Nuk informacin dhe analize te detajuar
Tregu dhe Konkurrenca	0	0	0	Nuk informacin dhe analize te detajuar
Vlera e aktiveve jomateriale	0	3,042,018	3,042,018	

Vlerësimi i emrit të mirë, ose "goodwill," të klubit futbollit Oriku bazuar në elementët e metodave të mësipërme duke vlerësimin e asetëve jo të prekshme që lidhen me reputacionin, markën, dhe bazën e tifozëve të klubit nga llogaritjet rezulton se në vlerën e kompanisë do të shtohet dhe shuma e vlersuar në tabelën nr 9 në shumën **3,042,018 lekë**.

3.3 Vlerësimi i aktiveve rrjedhëse

Vlera e mjeteve monetare në arkë dhe në llogarinë bankare në BKT të pasqyruar në pasqyrat financiare më datën 31.12.2023 paraqiten si më poshtë: - tabela nr 10

Tabela nr 10

Më 31 Dhjetor 2023	Vlera neto kontabël	Rregullimi i vlerës	Vlera e drejtë
Mjete monetare ne arke	0	0	0
Mjete monetare ne banke	1,023,734	0	1,023,734
Mjetet monetare	1,023,734	0	1,023,734

3.4 Vlerësimi i të drejtave të arkëtueshme

Vlera e të drejtave të arkëtueshme të pasqyruar në pasqyrat financiare më datën 31.12.2023 paraqiten si më poshtë: - tabela nr 11

Tabela nr 11

Më 31 Dhjetor 2023	Vlera neto kontabël	Rregullimi i vlerës	Vlera e drejtë
Nga aktiviteti i shfrytezimit	0	0	0
Te tjera tatime dhe tvsh	1,649,773	0	1,649,773
Kapital i nenshkruar i papaguar	3,000,000	0	3,000,000
Te drejta te arketueshme	4,649,773	0	4,649,773

Vlera e të drejtave të arkëtueshme të pasqyruar në pasqyrat financiare më datën 31.12.2023 teprica e pagesave për tvsh në shumën 1,649,773 leke dhe kapitali i papaguar në shumën 3,000,000 lekë. Në analizën e pagesave që Bashkia Vlorë gjatë gjithë jetgjatësë së aktivitetit të KF Oriku ka kryer pagesa të vazhdueshme ndaj shoqërisë për të cilën shoqëria duhet të kryente veprimet rregulluese për shumën e mësipërme . Vlerën e mësipërme ne do e marrim në konsiderat në vlersimin e aseteve të shoqërisë kur të vlersojmë postin e kapitali të shoqërisë.

3.5 Vlerësimi i gjendjeve të inventarit

Vlera e gjendje të inventarit të pasqyruar në pasqyrat financiare më datën 31.12.2023 paraqiten si më poshtë: - tabela nr 12

Tabela nr 12

Më 31 Dhjetor 2023	Vlera neto kontabël	Rregullimi i vlerës	Vlera e tregut të aktiveve neto
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	0	0	0
Produkte te gatshme	0	0	0
Mallra	0	0	0
Inventaret	0	0	0

Në kuadër të punës sonë për përcaktimin e vlerës së drejtë të shoqërisë, ne kemi kërkuar zyrtarisht informacion Bashkisë Vlorë me shkresën tonë nr 20 datë 29.04.2024 e protokolluar me nr 6510 datë 29.04.2024 në protokollin e bashkisë dhe e përsëritur kërkesa me shkresën nr 23 datë 16.05.2024 e protokolluar me nr 6510/1 datë 17.05.2024 në protokollin e bashkisë. Në përgjigjen e kthyer nga Bashkia Vlorë me shkresën nr 9605/1 datë 26.06.2024 rezulton se nuk kemi informacion mbi pronësinë e aseteve që përdorë Shoqëria "KF Oriku"sha . Në këto kushte nga verifikimi fizik dhe dokumentar rezulton se Stadiumi i Orikumit sëbashku me godinën e shërbimit dhe inventar ekonomik që përdor nuk janë pronë të shoqërisë por të Bashkisë Vlorë.

Vlera e drejtë e aktiveve afatgjata në përdorim të vazhdueshëm nuk janë pjesë e vlerësimit në këtë Raporti Vlerësimi për faktin se nuk janë pronë e shoqërisë (nuk ekziston një certifikatë pronësie apo kontratë përdorimi në emër të KF Oriku) . Inventari ekonomik i cili përbëhet nga 24 copë karrige kinemaje, 2 copë tavolina 1 njësi qendrore dhe 1 monitor referuar fletës së inventarit të datës 31 dhjetor 2023 janë pronë NJA Orikum. Vlera e gjendjes së inventarit është zero lekë në pasqyrat financiare të shoqërisë.

3.6 Vlerësimi i detyrimeve rrjedhëse dhe afatgjata

Detyrimet korrente në datën e vlerësimit përbëhen nga të pagueshmet tregtare dhe të tjera, të pagueshme ndaj tatim taksave dhe sigurimet shoqërore dhe Shuma e sponsorizmive të mbetur gjendje për vitin pasrdhës . Shoqëria nuk ka të pasqyruar detyrime ndaj institucioneve të kredisë ose ndaj të tretëve . Në vitin 2023 referuar transfertave të thesarit janë paguar nga ana e Bashkisë Vlorë shuma prej 5 milion lekë përfituar. Në pasqyrat financiare të shoqërisë vlera e borxheve është ndaj furnitorëve për blerje të mallrave dhe shërbime , shoqëria nuk ka të deklaruar detyrime afatshkurta dhe afatgjata ndaj të treteve dhe ndaj institucioneve të kredisë.

Vlera e detyrimeve rrjedhëse dhe afatgjata të pasqyruar në pasqyrat financiare më datën 31.12.2023 paraqiten si më poshtë: - tabela nr 13

Tabela nr 13

Më 31 Dhjetor 2023	Vlera neto kontabël	Rregullimi i vlerës	Vlera e drejtë
Detyrime afatshkurtra			
Detyrime ndaj institucioneve te kredise	0	0	0
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	1,051,132	41,469	1,092,601
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore	270,746	0	270,746
Te pagueshme per detyrime tatimore	0	0	0
Te tjera te pagueshme	0	5,000,000	5,000,000
Te ardhura te shtyra sponsorizime	1,006,062	0	1,006,062
Detyrime afatgjata			0
Titujt e huamarrjes	0	0	0
Detyrime ndaj institucioneve te kredise	0	0	0
Te ardhura te shtyra	0	0	0
Detyrime tatimore te shtyra	0	0	0
Te tjera te pagueshme	0	0	0
Totali i detyrimeve	2,327,940	5,041,469	7,369,409

Po, nëse shitet një kompani, borxhet e saj zakonisht do të ndikojnë në çmimin e shitjes. Në përgjithësi, çmimi i shitjes i kompanisë përfshin vlerën e saj të pasurive dhe detyrimeve. Pra, nëse një kompani ka borxhe, këto do të llogariten në çmimin e shitjes, dhe blerësi do të duhet të paguajë një çmim që përfshin borxhet ekzistuese të kompanisë. Kjo ndihmon në përlllogaritjen e çmimit të pastër të kompanisë pas përlllogaritjes së borxheve.

Për të përcaktuar vlerën e një kompanie futbollit, është e rëndësishme të përfshihen edhe borxhet që ka kompania ndaj të tretëve. Vlera e një kompanie të tillë zakonisht vlerësohet duke përfshirë gjithsej vlerën e pasurive dhe detyrimeve të saj, përfshirë borxhet. Kjo është e rëndësishme për të pasur një pamje të plotë të pasqyrës financiare të kompanisë. Vlera e drejtë e borxheve të shoqërisë që do të ndikojnë në çmimin e kompanisë është **6,092,601 lekë**.

3.7 Kapitali i shoqëisë

Kapitalit neto është një metodë që përdoret për të vlerësuar një biznes duke analizuar kapitalin e tij neto. Kapitali neto përfaqëson diferencën midis aktiveve totale dhe detyrimeve totale të një kompanie, duke ofruar një tregues të vlerës së pastër të aseteve të saj. Kjo metodë mund të përdoret në disa kontekste, si për të vlerësuar vlerën e një kompanie për qëllime shitjeje ose blerjeje, për të vlerësuar aftësinë e saj për të përballuar

borxhet, ose për të analizuar shëndetin financiar të saj. Kapitali neto i shoqërisë në datën 31.12.2023 paraqitet si më poshtë :- tabela nr 14

Tabela nr 13

Më 31 Dhjetor 2023	Vlera neto kontabël	Rregullimi i vlerës	Vlera e tregut të aktiveve neto
Toka dhe ndertesa	0	0	0
Riparim muri rrethues	88,908	0	88,908
Impiante dhe makineri	0	0	0
Të tjera Instalime dhe pajisje inventar informatik	0	0	0
Mjetet afatgjata	88,908	0	88,908
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	1,649,773	0	1,649,773
Llogaritë bankare dhe paratë e gatshme	1,023,734	0	1,023,734
Kapital i nenshkruar i papaguar	3,000,000	0	3,000,000
Pronat e tanishme	5,673,507	0	5,673,507
Totali i aktiveve	5,762,415	0	5,762,415
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	1,051,132	0	1,051,132
Huamarrjet - jo financiare	0	0	0
Detyrime të tjera korrente tatime sigurime	270,746	0	270,746
Te tjera te pagueshme	1,006,062	0	1,006,062
Kredi afatshkurtër - overdraft	0	0	0
Totali i detyrimeve korente	2,327,940	0	2,327,940
Detyrimet afatgjata - kredi bankare	0	0	0
Totali i detyrimeve afatgjata	0	0	0
Totali i detyrimeve	2,327,940	0	2,327,940
Asetet neto	3,434,475	0	3,434,475
Vlera e kompanisë	3,434,475	0	3,434,475

Burimi: KF ORIKU

Rezultatet e vlerësimit të Shoqërisë "K.F.Oriku" Sh.A është si më poshtë:

Vlera e Shoqërisë KF ORIKU sh.a	12,658,000 lekë
---------------------------------	-----------------

4- Metoda e kapitaleve neto të shoqërisë

Metoda e kapitalit neto është një metodë që përdoret për të vlerësuar një biznes duke analizuar kapitalin e tij neto. Kapitali neto përfaqëson diferencën midis aktiveve totale dhe detyrimeve totale të një kompanie, duke ofruar një tregues të vlerës së pastër të aseteve të saj. Kjo metodë mund të përdoret në disa kontekste, si për të vlerësuar vlerën e një kompanie për qëllime shitjeje ose blerjeje, për të vlerësuar aftësinë e saj për të përballuar borxhet, ose për të analizuar shëndetin financiar të saj. Kapitali neto llogaritet me formulën:

$$\text{Kapitali Neto} = \text{Aktivet Totale} - \text{Detyrimet Totale}$$

Përdorimi i kësaj metode ofron një pasqyrë të qartë të vlerës së aseteve të kompanisë, pas zbritjes së borxheve dhe detyrimeve. Bzuar në burimin e informacionit të shoqërisë rezulton se kapitalet neto paraqiten si më poshtë : - tabela nr 15

Tabela nr 15

Më 31 Dhjetor 2023	Vlera neto kontabël	Rregullimi i vlerës	Vlera e tregut të aktiveve neto
Toka dhe ndertesa	0	0	0
Riparim muri rrethues	88,908	0	88,908
Impiante dhe makineri	0	0	0
Të tjera Instalime dhe pajisje inventar informatik	0	0	0
Mjetet afatgjata	88,908	0	88,908
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	1,649,773	0	1,649,773
Llogaritë bankare dhe paratë e gatshme	1,023,734	0	1,023,734
Kapital i nenshkruar i papaguar	3,000,000	0	3,000,000
Pronat e tanishme	5,673,507	0	5,673,507
Totali i aktiveve	5,762,415	0	5,762,415
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	1,051,132	0	1,051,132
Huamarrjet - jo financiare	0	0	0
Detyrime të tjera korrente tatime sigurime	270,746	0	270,746
Te tjera te pagueshme	1,006,062	0	1,006,062
Kredi afatshkurtër - overdraft	0	0	0
Totali i detyrimeve korente	2,327,940	0	2,327,940
Detyrimet afatgjata - kredi bankare	0	0	0
Totali i detyrimeve afatgjata	0	0	0
Totali i detyrimeve	2,327,940	0	2,327,940
Asetet neto	3,434,475	0	3,434,475
Vlera e kompanisë	3,434,475	0	3,434,475

Burimi: KF ORIKU

Llogaritja e kostos mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC)

Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC - Weighted Average Cost of Capital) është një masë që reflekton koston mesatare që një kompani paguan për kapitalin e saj, duke përfshirë si kapitalin e huazuar (borxhin) ashtu edhe kapitalin e pronarëve (kapitalin e aksionerëve). WACC përdoret shpesh në vendimmarrjen e investimeve dhe në vlerësimin e ndërmarrjeve.

Për të llogaritur WACC, ndiqet formula:

$$WACC = \left(\frac{E}{V} \times Re \right) + \left(\frac{D}{V} \times Rd \times (1 - Tc) \right)$$

Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC - Weighted Average Cost of Capital) është një masë që reflekton koston mesatare që një kompani paguan për kapitalin e saj, duke përfshirë si kapitalin e huazuar (borxhin) ashtu edhe kapitalin e pronarëve (kapitalin e aksionerëve). WACC përdoret shpesh në vendimmarrjen e investimeve dhe në vlerësimin e ndërmarrjeve.

Ku:

- E - është vlera e tregut e kapitalit të pronarëve (kapitalit të aksionerëve).
- D - është vlera e tregut e borxhit.
- V - është vlera totale e kapitalit (E + D).
- Re - është kostoja e kapitalit të pronarëve.
- Rd - është kostoja e borxhit.
- Tc - është norma e tatimit mbi fitimin.

Kjo formulë përfshin:

- Koston e kapitalit të pronarëve (Re), që është kthimi që kërkojnë investitorët për kapitalin e tyre. Kjo mund të llogaritet duke përdorur modelin e çmimeve të kapitalit (CAPM) ose metoda të tjera.
- Koston e borxhit (Rd), që është kostoja e huave të marra nga kompania, shpesh e matur me normat e interesit të borxhit.
- Përqindja e kapitalit të pronarëve (E/V) dhe përqindja e borxhit (D/V) në strukturën e kapitalit të kompanisë.
- Faktorin e taksave (1 - Tc), që pasqyron përfitimet tatimore nga interesi i paguar mbi borxhet.

Modeli i Çmimit të Aseteve Kapitale (CAPM) është një model financiar i përdorur për të përcaktuar kthimin e pritshëm të një investimi bazuar në rrezikun e tij sistematik në lidhje me tregun e përgjithshëm. CAPM i ndihmon investitorët të kuptojnë marrëdhënien midis rrezikut dhe kthimit të pritshëm dhe përdoret gjerësisht në financa për çmimin e aktiveve dhe menaxhimin e portofolit.

Formula për CAPM është:

$$E(R_i) = R_f + \beta_i (R_m - R_f)$$

Ku:

$E(R_i)$ = Kthimi i pritshëm nga investimi

R_f = Norma pa rrezik, që përfaqëson kthimin e një investimi pa rrezik (p.sh. obligacionet qeveritare)

β_i = Beta e investimit, një masë se sa lëvizin kthimet e investimit në lidhje me kthimet e tregut

R_m = Kthimi i pritshëm i tregut

$R_m - R_f$ = Primi i rrezikut të tregut, kthimi i tepërt i pritshëm nga tregu mbi normën pa rrezik

Për të llogaritur normën e kapitalit neto para tatimit dhe pas tatimit, do të përdorim komponentët e kostos së kapitalit të përmendura më herët, përfshirë koston e borxhit dhe koston e ekutitetit.

Kostoja e ekutitetit (R_e) llogaritet duke përdorur Modelin e Çmimit të Pasurisë së Kapitalit (CAPM): $= 6.15\% + 0.88 * 11.3\% = 16.094\%$

Vlera e WACC paraqitet si më poshtë : - tabela nr 15

Tabela nr 15

Llogaritja e WACC	K.F ORIKU	Burimi
<u>Kostoja e kapitalit neto</u>		
Norma pa rrezik (indeksi 10-vjeçar i obligacioneve të qeverisë)	6.15%	Norma mesatare e interesit për letrat me vlerë 10-vjeçare të Qeverisë
Premia e borxhit	2.40%	Llogaritur si diferencë të normës pa risk dhe kostos mesatare të kredive investuese
Premium i kompanisë	2.04%	e vlerësuar
Kostoja reale e borxhit	10.59%	
<u>Kostoja e kapitalit neto, reale para tatimit</u>		
Norma e tatimit (15 %)	1.59%	Norma marxhinale e taksës së kompanisë
Ekuiteti beta	0.88	beta mesatare e kapitalit në vende të krahasueshme
Premium i rrezikut të kapitalit (ERP)	11.30%	e vlerësuar
Kostoja e kapitalit neto, reale para tatimit	16.09%	e llogaritur
<u>Kostoja e ponderuar e kapitalit</u>		
Kapitali	59.60%	Mesatarja e struktures se kapitalit te shoqërisë
Borxh	40.40%	Mesatarja e struktures se borxhit te shoqërisë
WACC i vlerësuar	13.23%	

Shuma e vlerës aktuale të flukseve monetare të lira për investitorët (flukset monetare pa borxh) në periudhën e parashikimit dhe vlera aktuale e vlerës së mbetur të biznesit dhanë një vlerësim të vlerës së biznesit të Kompanisë mbi bazën e interesit kontrollues të pa tregtueshëm paraqiten ne tabelën nr 16

Tabela nr 16

Pershkrimi	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Shkalla e rritjes së të ardhurave		5%	8%	8%	8%	8%
Të ardhurat	8,121,551	8,527,629	9,209,839	9,946,626	10,742,356	11,601,744
EBIT	79,752	170,553	221,036	278,506	375,982	452,468
Marzhi EBIT	1.0%	2.0%	2.4%	2.8%	3.5%	3.9%
<i>Rrjedha e parasë</i>						
EBIT	79,752	170,553	221,036	278,506	375,982	452,468
Taksa e rregulluar	0	0	0	0	0	0
Fitimi neto operativ minus tatimin e rregulluar	79,752	170,553	221,036	278,506	375,982	452,468
amortizimi	4,680	4,680	4,680	4,680	4,680	4,680
Fluksi i parasë bruto	84,432	175,233	225,716	283,186	380,662	457,148
Investimet neto (CapEx & OpEx)	0	0	0	0	0	0
Rrjedha e parave pa pagesë ("FCF")	84,432	175,233	225,716	283,186	380,662	457,148
FCF me zbritje	73,737	175,233	225,716	283,186	380,662	457,148
Shuma e FCF-ve me zbritje	1,595,682					
Vlera e Kompanisë	12,061,086					

Supozime dhe kufizime

Kjo detyrë është kryer me supozimet dhe kufizimet e mëposhtme të përgjithshme:

- Sipas njohurive tona më të mira, të gjitha të dhënat, duke përfshirë të dhënat financiare historike, nëse ka, të mbështetura në arritjen e opinioneve dhe konkluzioneve ose të parashtruara në këtë raport janë të vërteta dhe të sakta. Edhe pse të mbledhura nga burime që ne besojmë se janë të besueshme, nuk jepet asnjë garanci dhe as nuk merret përsipër përgjegjësi për vërtetësinë ose saktësinë e të dhënave, opinioneve ose vlerësimeve të dhëna nga të tjerët që janë përdorur në këtë analizë vlerësimi.
- Asnjë përgjegjësi nuk merret përsipër për çështje të natyrës ligjore. Asnjë hetim nuk është bërë për titullin ose ndonjë detyrim ndaj pronës së vlerësuar. Ne kemi supozuar se pretendimi i pronarit është i vlefshëm, të drejtat pronësore janë të mira dhe të tregtueshme dhe nuk ka barra që nuk mund të pastrohen përmes proceseve normale, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Raport.
- Vlerat e paraqitura në këtë raport bazohen në premisat e përshkruara këtu.
- Data e vlerësimit për të cilën zbatohen përfundimet dhe opinionet e shprehura përcaktohet në raport. Opinioni i vlerësimit i paraqitur aty bazohet në gjendjen e ekonomisë dhe në fuqinë blerëse të monedhës të deklaruar në raport në datën e vlerës.
- Duke marrë parasysh mjedisin e ndryshimit të vazhdueshëm të çmimeve që kanë ndikim në vlerësim, Raporti ynë është i kufizuar vetëm në ato çështje që na duket se kanë një ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e një vlere të përshtatshme për specifikën e pronës.
- Vlerësimi ynë bazohet në informacionin dhe të dhënat e ofruara nga shoqëria KF Oriku dhe Bashkia Vlorë. Ne jemi mbështetur në informacionin e marrë pa hetim shtesë ose konfirmim të pavarur për drejtësi dhe objektivitet të informacionit, dhe shumica e informacionit është mbledhur me kërkesën tonë.
- Fushëveprimi ynë i punës ka qenë i kufizuar për shkak të informacionit dhe të dhënave të pamjaftueshme të cilat nuk na janë prezantuar, dhe veçanërisht për sa vijon:
 - Plani i detajuar i zhvillimit të biznesit dhe shpjegimi i supozimeve për parashikimet financiare për periudhën nga janari 2024 e në vazhdim;
 - Raporte financiare dhe jofinanciare relevante që disponon shoqëria në vitet e fundit;
 - Listë të inventarit në përdorim ose në pronësi në proces hipotekimi oe jo;
 - Kontrata të lidhur me sportistët ose me subjekte sponsorizuese;
- Procedurat dhe kërkesat tona nuk përfshinin punë verifikuese ose nuk përbënin një auditim në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Prandaj, ne nuk

shprehim asnjë opinion për asnjë të dhënë financiare apo informacion tjetër të përmendur në këtë raport.

- Ne rezervojmë të drejtën të rishikojmë të gjitha llogaritjet e përfshira ose të referuara në raportin tonë dhe, nëse e konsiderojmë të nevojshme, të rishikojmë opinionin tonë në dritën e çdo informacioni ekzistues në datën e vlerësimit që na bëhet i njohur pas datës së këtij Raporti. Ne nuk kemi asnjë përgjegjësi për të përditësuar Raportin për ngjarjet dhe rrethanat që kanë ndodhur pas datës së këtij Raporti. Prandaj, ne nuk do të jemi përgjegjës për pasojat financiare ose të tjera që rrjedhin nga ndonjë gabim ose lëshim nga raporti ynë që rezulton nga kufizimet në fushëveprimi të përmendura në këtë raport dhe ju pranoni të na mbani të padëmshëm nga efektet e ndonjë gabimi të tillë ose mosveprim nëse nuk shkaktohet nga keqbesim nga ana jonë.
- Puna jonë ka qenë e kufizuar nga mungesa e të dhënave të tregut për çmimet e transaksioneve, kontratave të lidhura dhe të ngjashme për shkak të moszhvillimit të tregjeve dytësore për këtë lloj aktiviteti në vend.

AUDITUESI LIGJOR

Arqile Mishtaku

EKR, Msc Finance & Audit

License nr/74 date 31.01.2000

Ortak Angazhimi KEI-AL AUDITING shpk

Bulevardi "Ismail Qemali" P455/1 Ap, 2 Vlorë



Vlorë më, 25 Korrik 2024